RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI

"AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË"

NË BASHKINË PUSTEC

Tiranë, dhjetor 2021

🕮 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	**PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**	**4 – 17**
2.	Përshkrim I gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeveé é é é é é é é é é é é	**4 – 15**
3.	Konkluzion I përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimité é é é é é é é é é é .	**15 – 17**
II	**HYRJA**	**17 - 24**
	a. Objektivat e auditimit..... *b. Qëllimi i auditimit.....* *c. Identifikim i cështjes.....* *d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....* *e. Përgjegjësitë e Audituesve.....* *f. Kriteret e vlerësimit .....* *g. Standardet e auditimit.....* *h. Metodat e auditimi .....* *i. Dokumenti i auditimit.....*	
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....**	**24 – 71**
1.	**Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....**	**24-24**
2.	**Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të audimit.....**	**25 – 71**
1.2.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, ligjet vjetore ñPër buxhetin e shtetitò , si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.....	26 ï 33
1..2.6	Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.....	33 ï 37
2.2.	Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò.....	37 - 58
3.4	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, Manualeve përkatëse të punimeve, udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik etj.....	59 ï 71
IV.	**KONKLUZION I PËRGJITHËHM .....**	**71– 81**
V.	**ANEKSE.....**	**82 - 94**

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
SNA	Standardet ndërkombëtare të auditimit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MIE	Ministria e Industrisë dhe Energjetikës
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues.
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	AB
MAB	Manuali i AB
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
IT	Teknologjia e Informacionit
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
AK	Autoritet Kontraktor
DT	Dokumentet e tenderit
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
KSHA	Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave
NJHDT	Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1-Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñMbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Pustec në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 870/1 *prot*, datë 01.09.2021, ndryshuar me shkresën nr. 870/2 datë 06.10.2021 nga data 07.09.2021 deri më datë 22.10.2021, në subjektin Bashkia Pustec, për periudhën e veprimtarisë së subjektit, nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2020.

Auditimi u krye me zgjedhje për pasqyrat financiare të vitit 01.01.2018 deri 31.12.2020, si dhe për veprimtarinë ekonomiko-financiare, mbi bazë materialitetin dhe risku, zbatimine buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Pustec dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.15 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimit me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga data baze i thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 ñpagaò; 401-408 ñ*Furnitorë e llogari te lidhura me to*ò; 467 ñ*Kreditore te ndryshëm*ò; 602 ñ*Shpenzime operative*ò dhe 230- 231 ñ*Investime*ò, si dhe me zgjedhje procedurat e prokurimit zbatimi i kontratave të ndërtimit.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, të shpërblimeve të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Me shkresën nr. 1658 datë 13.12.2021, e protokolluar në KLSH me nr. 870/6, datë 20.12.2021, nga subjekti Bashkia Pustec janë paraqitur vërejtjet e Projekt Raport Auditimit, ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato raste për të cilat kishin mbështetje ligjore me dokumentacion, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentin e duhur ligjor, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 3 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.2. Përshkrim i shkurtër i Projektit tëAuditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	Pasqyrat financiare të viteve 2019 dhe 2020 (bilanci), janë mbyllur jashtë afatit ligjorë, konfirmuar me shkresën me shkresë përcjellëse nr. 788 prot., datë 27.07.2020, për vitin ushtrimor 2019 dhe shkresën nr. .777 datë 11.06.2021. për vitin 2020, të konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të viteve 2019-2020 me anekset përkatëse, *pra me 3 muaj vonesë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronjën (d) e pikës 4 e nenit 9, dhe shkronjës (b) e pikës 2 të nenit 12, të ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit"; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 118.*	**I lartë**	**37-58**	Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos mbylljes në afat të pasqyrave financiare për vitet 2019 dhe 2020, duke evidentuar personat përgjegjës dhe të marrë masë ndaj tyre në zbatim të shkronjës (e) të nenit 71-*Kundërvajtje administrative,* të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SHò, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016. -Në pasqyrat financiare të përshkruhet qartë baza mbi të cilën janë përgatitur, duke referuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për klasifikimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Përgjegjësia për raportim në çdo kohë të jetë e dokumentuar jo nëpërmjet shkresës përcjellëse të dërgimit të pasqyrave, por evidentohet në përgjegjësi të plotë në kapakun e pasqyrave financiare, se kush janë hartuesit dhe drejtuesit.
2	Në fund tëvitit 2020 llogaria **468 "Debitorë të ndryshëm"** paraqitet në vlerën **129,768** lekë për 33 raste, të cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Konstatohet së vlera **129,768** lekë janë detyrime përpara vitit 2015 të trashëguara nga ish komunat. i ciliështë detyrim i pa definuar, pa dokumentacionin përkatës për t`u paraqitur si detyrim ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera, i mbartur, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur, *në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 6.* Sipas akt rakordimit të mbajtura nga sektori i të ardhurave me degën e thesarit, debitorët e subjekteve taksapagues privat dhe familjar, janë në	**I lartë**	**37-58**	-Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në fund të vitit ushtrimor 2020 në vlerën **15,039 mijë lekë** sipas evidencave të Sektorin të të Ardhurave Vendore. -Sektori i Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	vlerën prej **15,039 mijë** lekë gjendje 31.12.2020. Nga analiza e llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò konstatohet sevlera prej **15,039 mijë** lekë nuk është pasqyruar në kontabilitet. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò*Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" , aneksi 1, pika 3.3.*			
3	Llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 6,393,315 lekë, kurse më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 1,437,029 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar pasi llog. 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò përfaqëson vlerën kundër parti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit. Vlera debitorë e kësaj llogarie, nuk është e kuadruar me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të cilave është në shumën totale 2,033,221 lekë sipas llogarive dhe as është e analizuar sipas llojeve të detyrimeve të pa paguara si më poshtë vijon: -Llogaritë 401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò për vlerën kontabël për 435,624 lekë dhe llogaria 467 ñKreditorë të ndryshëmò për vlerën kontabël 1,597,597 lekë. *Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.*	**I lartë**	**37-58**	-Bashkia Pustec, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò dhe kundër partisë së saj 467 ñKreditorë të ndryshëmò -Sektori i financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet të llogarisë 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò duke pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 **"**Kreditorë të ndryshëmò në pasiv të bilancit, detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore si dhe nga detyrimet kontraktore të cilave i ka kaluar afati 60 ditor në vlerën **435,624 lekë.** Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.
4	Llogaria 202 ñStudime dhe kërkimeò, më	**I mesëm**	**37-58**	Sektori i Financës në Bashkinë Pustec të

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	31.12.2019 paraqitet në vlerën 2,558,433 lekë, ndërsa më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 18,399,892 lekë, me diferencë në rritje në vlerën 15,841,459 lekë e cila përfaqëson shtimin e tre projekteve për vitin 2020, (Për 2 Blerje projekti studim Uji i Pijshëm dhe Oponence teknike KUZ, Bashkia Pustec). Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se vlera **2,558,433lekë**, i përkasin 20 projekteve për investimet e kryera, për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, sipas aneksit në vijim. Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve *e analizuar sipas aneksit nr.4, pika 3, për projektet, studimet e kërkime dhe vlerat përkatëse, gjendje më 31.12.2020 bashkëlidhur projekt raportit. Veprime dhe mos veprimet janë në kundërshtim të UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika "c", nën pika "b".*			kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 ñ*Studime dhe Kërkime"* dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.
5	**G**jendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën neto) për vitin 2020 në vlerën **156,289,659** lekë dhe për vitin 2019 në vlerën**164,540,191** lekë nuk është paraqitur i plotë. Sipas inventarit **kontabël të aktiveve afatgjata materiale** gjendja e llogarive: ***210"Toka, Troje, Terrene"*** është në vlerën 0 lekë; llogaria ***211"Pyje, Plantacione"*** në vlerën 1,793,836 lekë, llogaria ***212 "Ndërtesa Konstruksione"*** në vlerën 44,101,936 lekë; llogaria ***213"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*** në vlerën 96,980,075 lekë; llogaria ***214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** në vlerën 5,764,200 lekë. Sa me sipër pasqyrimi i gjendjes kontabël i aktiveve **nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv**	**I lartë**	**37-58**	- Sektori Ekonomike në Bashkinë Pustec të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një **regjistri analitik aktivesh sipas formatit,** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv. Nga Dega e Thesarit Korçë nuk është kërkuar regjistri aktiveve për regjistrimin në sistemin informatikë financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një data basë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Pustec, pra duke mos u kryer proçesi i informatizimit të tyre, veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò kapitulli III, pika 30.			
6	Llogaria 26 ñ*Aktive afatgjata Financiare*ò,sipas pasqyrës financiare paraqitet me vlerë zero lekë për periudhën objekt auditimi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Pustec, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 13/09/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Pustec SHA me NUIS ñL74004003Bò e cila është shoqëri aksionare me objekt ñShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyreò. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqiò.	**I lartë**	**37-58**	Bashkia Pustec, nëpërmjet Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek ñUjësjellës Kanalizime Pustec Sh.a me vlerë 58,800,000 lekë, në debi të llog. 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 58,800 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 58,800,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalitme 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pustec në ñUjësjellës Kanalizime Pustec SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019-2020, më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialëò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.			
7	Llogaria **466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", më 31.12.2020 paraqitet në vlerën** 2,098,102 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh, për objekte të përfunduara dhe në proces. Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:** a)Në pasqyrat e pozicionit financiar llogaria 466, kreditorë për mjete në ruajtje paraqitet në vlerën 2,098,102 lekë, ndërsa në mënyrë analitike paraqitet në vlerën 2,043,102lekë për 19 subjekte,me diferencë më pak në vlerën 55,000 lekë ei korrespondon taksës së pullës në fund të periudhës 2020 b) Për 19 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 2,043,102 lekë, *sipas aneksit nr.11, pika 3,* nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre	**I lartë**	**37-58**	Sektori i Financës të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 ñ*Kreditore për mjete nën ruajtje*ò, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. *Veprimet e mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 30, 50.*			
8	Bashkia Pustec nuk ka krijuar sektorin e Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve dhe për rrjedhojë procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave tëtransferimit në NJQV, vënien në eficencë të ndërtesave dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive me sipërfaqe gjithsej 706 ha, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III ñRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreò, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.Bashkia Pustec ka vazhduar punën s*ipas Urdhrit të Kryetarit të bashkisë nr. 166 datë 31.10.2019 mbi ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e objekteve prioritare të bashkisë sipas listës përfundimtarë për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksioninterritorial të bashkisë Pustecdhe me Udhërin nr. 149 prot, datë 27.09.2021 është bërë zëvendësimi i njëanëtari të larguar* **.** *Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit grupi i punës nuk ka përfunduar punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje,*	**I mesëm**	**37-58**	- Bashkia Pustec, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Pustec dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore etj sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, i ndryshuar.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	kullota, ndërtesa etj.) dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar. *Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore", transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore", si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike".*			
9	Bashkia Pustec, *nuk ka kryer procedurat për inventarizimin* e të gjitha aktiveve afat gjata jo materiale dhe materiale të investuara në vite nga Bashka Pustec dhe ato që me miratim të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të kësaj bashkie, konkretisht për llogaritë (me kostot historike): Llogaria 202 ñStudime dhe kërkimeò për vlerën 18,399,892 lekë Llogaria 211 ñ*Pyje kullota plantacione"*për 1,793,836 lekë. Llogaria 212 ñ*Ndërtime konstruksione*òpër 50,082,499 lekë. Llogaria 213 ñ*Rrugë rrjete vepra ujore*ò për 123,401,363 lekë. Llogaria 214 ñInstalime teknike,makineri, pajisje,vegla puneò për vlerën 8,527,462 lekë Llogaria 215 *"Mjete transporti*òpër 36,425,797 lekë. Llogaria 218 ñInventar ekonomikòpër vlerën 5,241,702 lekë ***-Nuk është përgatitur regjistri i pronave.*** ***-Nuk është bërë regjistrimi i aktiveve në pronësi të Bashkisë***.	**I lartë**	**37-58**	-Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet të kaluara me VKM-të përkatëse, si dhe për krijimin e regjistrit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, i ndryshuar.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë; Kap. VII, neni 23, pika 14 –Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj , UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme". Kap III.			
10	Bashkia Pustec ka lidhur Kontratë Qiraje nr. 29108, datë 09.04.2008, me Subjekti ñT. A. òSHA, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të ish-Komunës Liqenas (sot Bashkia Pustec) për 300 m^2 për ndërtim të stacionit të antenave, me afat 10 vjeçar (09.04.2008 deri 09.09.2017), me të drejtë rinovimi çdo vit, me vlerë 300,000 lekë/vit,Kontratë Qerejenr. 28/17, datë 09.04.2017, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik për 205 m^2 për ndërtim të stacionit të antenave, me afat 10 vjeçar (09.04.2017 deri 09.04.2026), me të drejtë rinovimi çdo vit, me vlerë 191,500 lekë/vit dhe Kontratë Qerejenr. 66/08, datë 12.11.2009, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik për 150 m^2 për ndërtim të stacionit të antenave, me afat 10 vjeçar (12.11.2009 deri 12.11.2018), me të drejtë rinovimi çdo vit, me vlerë 150,000 lekë/vit, vlerat e kontratës janë llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotaveò, lidhjes 2, pika 6 *"Për vendosje antene"* Nga të dhënat e marrë në zyrën e	**I lartë**	**26-37**	Bashkia Pustec të marrë masa, duke ndjekur t gjitha procedurat administrative e ligjore pë arkëtimin e **vlerës 300,000 lekë** nga subjekt ñT. A. ò SHAduke llogaritur edhe penalitete përkatëse.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	financës, rezulton se subjekti ñA. T.ò SHA nuk ka likuiduarpër kontratënnr. 1005, datë 15.06.2011, për kontratën nr. 66/08, datë 12.11.2009, detyrimin e viti 2020-2021 për vlerën **300,000 lekë,** detyrim gjithsej i palikujduar në vlerën **300,000 lekë** , është shkelje e disiplinës financiare me **dëm për buxhetin të Bashkisë Pustec,** veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me kushtet e kontratave Kontratës së Qirasë me nr. 29108, datë 09.04.2008, me Subjekti ñT. A. òSHA, nenin 12,ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollinò si dhe ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 ñKodi Civilò, neni 801 e vijues, referuar nenit 815, citohet ñQiramarrësi që është në vonesë për të kthyer sendin, detyrohet tõ japë qiradhënësit pagesën e caktuar deri në dorëzim, përveç detyrimit për të shpërblyer dëmin përkatësò			
11	Si rezultat i punës së pa mjaftueshme të zyrës së taksave dhe tarifave vendore, në fund të vitit 2020, rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore në **vlerën totale 15,039,140 lekë,** e cila përbëhet nga detyrimet e 10 subjekteve privat në shumën **225,921 lekë** dhe vlera **14,813,219 lekë** detyrime për taksat dhe tarifat vendore nga taksapaguesit familjar. Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, nenet 90 dhe 91, të ligjit nr. 9920, òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar dhe pika 12 të Udhëzimit te Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve”	**I lartë**	**26-37**	- Nga Sektori i Financës dhe Sektori i Taksave në Bashkinë Pustec, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve tatimoredhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore,për 10 subjekte debitorë të biznesit të vogël dhe të biznesit të madh si dhe 1355 debitorë në shumën 14,813,219 lekë, për taksat dhe tarifat vendore nga taksapaguesit familjar, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò, i ndryshuar,duke ndjekur rrugët e mëposhtme: **a.** Tõu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar. **b.** Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar. **c.** Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
				tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar.
12	Në Bashkinë Pustec për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 ï 31.12.2020, janë realizuar gjithsej **8** procedura me fond limit 39,831 mijë lekë. Grupi i KLSH-së, referuar të dhënave të riskut nga **8** procedura me fond limit 39,831 mijë lekë ka vlerësuar për auditim **3** procedura me fond limit 32,331 mijë lekë ose 81.7 % të fondit të prokuruar. Nga auditimi i 3 procedura me fond limit 32,331 mijë lekë, u konstatua se në **2** procedura mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, si në aplikimin e kritereve dhe në shpalljen fitues të operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë disa nga kriteret e veçanta për kualifikim, të përcaktuara në DT, duke përdorur fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën**28,497 mijë lekë** ose 71.5 % e fondit limit të audituar respektivisht; **Për vitin 2018**, në 1 nga procedurat e prokurimit me fond limit 5,916,666 lekë, konkretisht: -Sistemim asfaltim rruge fshati Dollna Gorica, me fond limit 5,916,666 lekë; **Për vitin 2019:** në 1 nga procedurat e prokurimit me fond limit 22,581,165lekë, konkretisht: -Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Pustec, me fond limit 22,581,165 lekë. Veprimet janë në kundërshtim me ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, përkatësisht: neni 2, *"Parimet e përzgjedhjeje",* neni 24, *"Anulimi i një procedure",* neni 46, *"Kualifikimi i ofertuesve"*, pika 1, neni 47,	**I lartë**	**59-71**	Nga ana e Bashkisë Pustec, të merren masa për eliminimin e praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	ñ*S`kualifikimi i ofertuesve*ò, neni 53, *"Shqyrtimi i ofertave"*,neni 55, *"Kriteret e përcaktimit të ofertës"*, neni 58, *"Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës"*, pika 1; VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, nenet: 26, ñ*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*ò, pika 5, neni 66, ñ*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*ò, neni 67, *"Klasifikimi i ofertave"*, neni 69, *"Njoftimi i fituesit"*, neni 70 *"Lidhja e kontratës"*, neni 78 ñ*Ankesat në autoritetin kontraktor.*			

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një ñ**Opinion të kundërt"**, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.
- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2018 ï 31.12.2020, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Pustec bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kritereve dhe shpalljen fitues të OE me kritere jo të plotësuara, materiale dhe të përhapura që janë baza për dhënien enjë **"Opinion të kundërt".**

Gjithashtu u konstatua se:
- Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjare, nuk është ndjekur e plotë procedura në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 9920, datë 28.5.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në RSH*ò, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò, me ndryshime dhe Vendimeve të KB, duke evidentuar një të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Pustec në vlerën **15,339 mijë lekë,** *nga e cila borxhi nga taksat e tarifa vendore në vlerën* ***15,039 mijë lekë.***
Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, Aktrakordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-*paga*; 202- *Studime dhe kërkime*; 401-408-*Furnitorë e llogari te lidhura me to*; 467-*Kreditore te ndryshëm*; 602-*shpenzime operative*; 215-*Mjete transporti*; 218-*Inventar ekonomik*; 32-*Objekte inventari* dhe 230- 231-*investime*, si dhe **8** procedura me fond limit 39,831 mijë lekë ose 81.7 % e fondit limit të prokuruar për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 ï 31.12.2020.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi pasqyrat financiare.

Opinion i kundërt. KLSH ka audituar pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Pustec për vitin ushtrimor 2019 dhe 2020, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e fluksit të arkës, pasqyra e lëvizjes së kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat. Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kundërt për llogaritë vjetore të subjektit, Bashkia Pustec, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2020, pasi anomalitë e pa sistemuara të vitit 2019 pasqyrohen në vitin pasardhës, pasqyrat financiare përgjatë përgatitjes dhe raportimit financiar të transaksioneve për ekzekutimin e buxhetit, shoqërohen me mangësi dhe parregullsi të cilat janë materiale dhe të përhapura, në mospërputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare (ISSAI 1700)[1]KLSH ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare"*, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendura në ISSAI-n 5000 -Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare -Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për dhënien e opinionit të kundërt. Hartimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2020 nuk ka të përfshirë të gjitha aktivet e katër llogarive kryesore të aktiveve afatgjata materiale: Llogaria 210 ñToka, troje, terrene, Llogaria 211 ñPyje kullota plantacioneò, Llogaria 212 ñNdërtesa e Konstruksioneò, Llogaria 213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò, duke sjellë si pasojë mos pasqyrim të saktë të tyre në pasqyrat financiare. Për këto aktive nuk është hartuar regjistri kontabël, nuk janë përfshirë në procesin e inventarizimit vjetor dhe nuk janë regjistruar në ZVRPP (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës).

Përgjegjësitë e drejtuesve të njësisë vendore .Drejtimi i njësisë vendore, Bashkia Pustec, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 25/2018, ñ*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*ò, UMF nr. 8, datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò me ndryshime dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

[1]*Opinioni i kundërt shprehet kur ka të dhëna të mjaftueshme se parregullsitë, individualisht apo së bashku janë materiale dhe të përhapura në pasqyrat financiare*

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi material apo anomalie që mund të ekzistojë.

Opinion i auditimit mbi përputhshmërinë:

Për drejtimin e Bashkisë Pustec.

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë vendore me kuadrin rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve publike si dhe planifikimin dhe zbatimin e buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet). Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, duke arritur në përfundimin se devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura, mbështetur në standardet ISSAI 4100 shprehim një **opinion të kundërt**[2]për përputhshmërinë, për periudhën e auditimit 01.01.2018 deri më datën 31.12.2020.

Baza për dhënien e opinionit

- Janë konstatuar shkelje dhe mospërputhshmëri materiale, në fushën e prokurimeve publike. Nga 3 procedurat e prokurimit të audituara, të 3 prej tyre në vlerën 32,331,000 lekë, ose 81% e vlerës së procedurave të zhvilluara, janë konstatuar me shkelje të cilat lidhen me hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim, konkretisht mos argumentimi i kritereve dhe vendosjen e tyre jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimi, 2 prej tyre në vlerën 28,497,831 lekë, ose 71% e vlerës së procedurave të zhvilluara, janë konstatuar me shkelje të cilat lidhen me kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi .

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pustec:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Pustec, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Pustec janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[3], nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

[2]*Opinioni i kundërt shprehet kur ka të dhëna të mjaftueshme se parregullsitë janë materiale dhe të përhapura*

[3]*ISA 200-ISSAI 1200Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.*

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 870/1, datë 01.09.2021ndryshuar me shkresën nr. 870/2, datë 06.10.2021 "Njoftim për ndryshim në programin e auditimit nr. 870/1, datë 01.09.2021", të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 07.09.2021 deri më datë 22.10.2021, në subjektin Bashkia Pustec, për periudhën e veprimtarisë së subjektit, nga data 01.01.2018 deri në 31.12.2020, u krye auditimi ñMbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisëò, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. H. I., Auditues, Përgjegjës Grupi.
2. L. B., Auditues.

a- Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Pustec.

b- Marrësi: Raporti i Auditimit i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Pustec

c- Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2019 dhe 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.
- Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve.
- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.
- Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.
Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse

informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.
Gjithashtu, pjesë e Raportit të Auditimit do të jetë, opinioni mbi përputhshmërinë, nëse procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kriteret e paracaktuara).

d- <u>Identifikimi i çështjes</u>: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi tõ shërbejë subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.
Sipas përcaktimit të ISSAI 100 ñAuditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimiò, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.
Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Pustec, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.
Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për te dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Pustec.

e- <u>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</u>: Administratori i përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) z. P. K. Kryetar i Bashkisë Pustec dhe përgjegjës Sektori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ) z. C. N., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Pustec, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, konkretisht neni 34, pika 6[4], neni 65, pika 1[5] dhe neni 91, pika 1.3[6].

---

[4]"Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore"
[5]"Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori".
[6] "Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:
a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

f- <u>Përgjegjësitë e Audituesvetë KLSH</u>-së: Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar.
Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:
a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik, etj.
b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
c) Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)
e) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës, etj.;
Në përputhje me ISSAI 1320, dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.
Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në Bashkinë Pustec, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit.

g- <u>Kriteret e vlerësimit</u>: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

- **<u>Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar*:*</u>**

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ñPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006, aktualisht i shfuqizuar; Ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 ñPër buxhetin e vitit 2018ò, ligji nr. 99/2018, datë 31.12.2018 ñPër buxhetin e vitit 2019ò, Ligji nr. 88/18.12.2019 ñPër buxhetin e vitit 2020ò dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 ñPër huamarrjen e qeverisjes vendoreò; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 ñPër pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtareò ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.903.2015; VKM 783 datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlò; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 ñPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëmò; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetitò, etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e

---

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;
ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit".

përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 ñPër përgatitjen e buxhetit vendorò; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 ñPër buxhetin e vitit 2018ò, pikat 82-91 ñDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendoreò; Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 ñPër buxhetin e vitit 2019ò, pikat 106-110, ñDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò, dhe pikat 116-117- Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendoreõõ.

- **<u>Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit Pasqyrave Financiare:</u>**

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuarligjin nr. 9477 datë 9.2.2006ò, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, date 10.4.1998 ñPër miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyreò i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabëlò; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ñPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialò; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 ñPër procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorialò.

- **<u>Në fushën e prokurimeve publike:</u>**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të Prokurimit Publikò dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publikò, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 ñPër procedurën e prokurimit me vlera të voglaò, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 ñPër gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartëò.

- **<u>Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:</u>**

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuarò; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 ñPër Sistemin e Taksave Lokaleò, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, ñPër Taksat Kombëtareò, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyreò, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, ñPër disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar.

- **<u>Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit:</u>**

Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, ñPër kundërvajtjet administrativeò; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 ñPër Inspektimin në Republikën e Shqipërisëò; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, ñPër lejet e mjedisitò; Ligji Nr. 107-2014, ñPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò; Ligji nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò; VKM nr. 629, datë 15.7.2015, ñPër miratimin e manualeve të ndërtimitò; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër

miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuarò; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 ñPër unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendoreò; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 ñPër procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandaraò dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

- **<u>Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:</u>**

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, ñPër Nëpunësin Civilò, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, ñPër kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeveò, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, ñPër Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilëò, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, ñPër Pagat e Vetëqeverisjes Vendoreò, i ndryshuar.

h- <u>Standardet e auditimit</u>: ISSAI 100 ñParimet themelore të auditimit të sektorit publikò, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 ñUdhëzues të Auditimit Financiarò; ISSAI 2300 ñPlanifikimi i auditimit të pasqyrave financiareò; INTOSAI GOV 9100 ñUdhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publikò si dhe INTOSAI GOV 9110 ñUdhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëmò; ISSAI 400 ñParimet themelore të auditimit të përputhshmërisëò, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 ñPrezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisëò; si dhe ISSAI 4200 ñUdhëzime për auditimin e përputhshmërisëò; INTOSAI ñPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisëò; etj. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

i- <u>Metodat e auditimit</u>: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efiçencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[7].

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tësu audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

[7] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna ñjashtë normalesò, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- *Intervista*
- *Raporte dhe Informacione*
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK*

j- <u>Dokumentimi i auditimit</u>: Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tû audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të

kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja[8].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.
Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose ne trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve dhe Akt-Verifikimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të kundërshtive të subjektit nën auditim të Projekt raporteve të Auditimit, u përgatit ky Raport Auditimi.

[8] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm ∗ Risku i kontrollit ∗ Risku i Zbulimit

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

I1.1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik Bashkia Pustec:

Bashkia Pustec ka një popullsi rreth 5,200 banorë. Si rezultat i reformës administrative-territoriale nuk ka përfshirë njësi të tjera administrative, pra është vazhdim i ish Komunës Pustec. Veprimtaria e njësisë vendore bazohet në një bazë të gjerë ligjore, por ligji bazë për të është ligji nr.139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò . Bashkia Pustec si njësi vendore kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit.	

Profili i Bashkisë

Veprimtaria e Bashkisë Pustec bazohet në një bazë të gjerë ligjore, por ligji bazë për të është ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, i ndryshuar.

Parimet themelore të vetë qeverisjes vendore janë: të veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore dhe të respektojnë kushtetutën.

Auditimi i këtij subjekti është auditim i radhës, sipas planit vjetorë të miratuar në fillim të vitit 2021, nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit.

Bashkia e re e Pustecit ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë, si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë. Maqedoninë etj.

Bujqësia është e përqendruar të agrumet, dhe vreshtat ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

Infrastruktura e zonës është sistemuar me ndërtimin e rrugëve lidhëse ndërmjet Njësive Administrative dhe autostradës me qëllim krijimin e lehtësirave për bizneset vendase që merren me tregtimin e fruta perimeve si dhe blegtorinë.

Sfidat me të cilat do të përballet pushteti vendor pas ndarjes së re

Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke u bazuar te praktikat e suksesshme të kooperativës është një sfidë që duhet të marrë parasysh nevojën për të krijuar kushte të mira jetese për popullsinë duke shmangur në këtë mënyrë emigrimin e mëtejshëm.

Krijimi i mundësive për zhvillimin e Agro turizmit në pajtim me natyrën, investime publike si dhe planifikim të mirë dhe transparent të zhvillimit.

III/1.1 REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

1/1 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, ligjet vjetore ñPër buxhetin e shtetitò të vitit 2018 - 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

Programimi i PBA 2018, 2019, 2020

Nga Bashkia Pustec, janë miratuar treguesit e buxhetit afatmesëm (PBA) për periudhën e viteve 2018-2020.

Titullari i Bashkisë Pustec në përputhje me kriteret dhe kërkesat e ligjit 9936, datë 26.06.2008 ñ*Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, ñ*Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñ*Për sistemin e taksave vendore*ò të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, ñ*Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore*ò, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ñ*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*ò, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 ñ*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor*ò ka paraqitur në Këshillin e Bashkisë planin e punës për përgatitje e buxhetit afatmesëm 2018-2020 , i cili është miratuar me VKB nr.75, datë 25.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.15/1, datë 15.01.2018 për vitin 2018-2020.

Projekt buxheti për vitin 2018-2020 janë hartuar konform legjislacionit të mësipërm, në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues, si për fazën e parë dhe për fazën e dyte te PBA 2018-2020 me shkresën nr. 235, datë 13.09.2017. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2018-2020, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 12 - programe buxhetore. Gjatë hartimit të PBA për vitet 2018-2020 janë përcaktuar ñPërshkrimiò i çdo program, ñPolitika e programitò, ñQëllimi i Politikës së programitò, ñObjektivat e politikës së programitò. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij, shpërndarja e fondeve sipas programeve paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Programimi i shpenzimeve për vitin 2018, 2019 dhe 2020 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	**01110** (Planifikim, Menaxhim dhe Administrim)	55,691	95,7	29,397	50,31	38,726	65,4%
2	**03140** (Shërbimet e Policisë Vendore)	0	0	0	0	0	0
3	**03280** (Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile)	0	0	8,861	15,2	8,861	15
4	**04240** (Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit)	484	1.2	0	0	0	0
5	**04260** (Administrimi i pyjeve dhe kullotave)	100	0.81	4,209	7,2	3,511	5,9
6	**04520** (Rrjeti rrugor rural)	0	0	305	0.52	1,021	1.7

7	**06260** (Shërbimet publike vendore)	0	0	0	0	0	0
8	**08130** (Sport dhe argëtim)	200	0.16	0	0	0	0
9	**08220** (Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore)	0	0	0	0	0	0
10	**09120** (Arsimi parashkollor, përfshirë arsimi bazë)	1,800	3,08	5,783	9,9	7,084	12
11	**09230** (Arsimi i mesëm i përgjithshëm)	0	0	0	0	0	0
12	**10140** (Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara)	150	0.25	9870	16,9	0	0
	TOTALI	**58,425**	**100%**	**58,425**	**100%**	**59,203**	**100%**

Ndërsa ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2018, 2019 dhe 2020 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Pag, sig.,Bashkia,Gj. Civ e QKB	32,200	54.5	33,546	74.3	37,570	59.9
2	Shpenz (602, 603, 604 dhe 606)	15,650	39	20,125	22.4	20,035	37.1
3	Investime	10,575	6.5	4,754	3.3	1,598	3
	Total	**58,425**	**100%**	**58,425**	**100**	**59,203**	**100**

Sipas PBA 2018-2020 tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë**:**

Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2019-2021

A	**Të ardhurat**	**2018**	**2019**	**2020**
1	Nga taksat	3,096	3,184	3,184
2	Jo tatimore	5,775	6,055	6,465
3	Trashëguar nga viti mëparshëm	0	0	0
I	**Totali**	8,871	9,239	9,649
1	Transferta e pakushtëzuar	31,463	31,463	31,463
2	Transfertë specifike	8,091	8,091	8,091
3	Transfertë e pakushtëzuar specifike	0	0	0
4	Të tjera transf. Spec dhe kushtëzuara trashg	10,000	10,000	10,000
5	Transfertë e zhvillimit të rajoneve	0	0	0
II	**Shuma e transfertave**	**49,554**	**49,554**	**49,554**
III	Totali i burimeve të veta (I +II)	**58,425**	**58,425**	**59,203**

<u>Programimi i buxheteve vjetore të viteve 2018, 2019, 2020.</u>

Për vitin 2018 buxheti është miratuar me VKB nr. 65, datë 25.12.2017, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.15/1, datë 15.01.2018.

Për vitin 2019 buxheti është miratuar me VKB nr.90, datë 19.12.2018, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.1571/1. datë 09.01.2019.

Për vitin 2020 buxheti është miratuar me VKB nr.103, datë 24.12.2019, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë me shkresën nr.1659/1, datë 09.01.2020.

Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë Pustec për vitin 2018, 2019 dhe 2020 paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

në 000/lekë

Nr	**Emërtimi**	**Viti 2018**		**Viti 2019**		**Viti 2020**	
		Të ardhurat	**Shpenzime**	**Të ardhurat**	**Shpenzime**	**Të ardhurat**	**Shpenzime**
	Te ardhurat						
1	Të ardhurat e veta	7,600	0	10,000		9,500	
2	Granti i pakushtëzuar	32,536	0	33,765		34,566	
3	Grant i pakush .specifik	17,958	0	18,063		23,508	

4	Të ardhura të trashëguara	17,221	0	24,003		18,512	
5	Të ardhura të trashëguara nga grantet konkurruese	0	0	0		0	
6	Fonde të pritshme nga BE	0	0	0		27,505	
	Shuma	**75,315**	**0**	**85,831**		**113,591**	
	Shpenzimet						
1	(600) Shp. për paga		31,670		37,956		43,423
2	(601) Shp për sigurime		5,269		7,166		8,481
3	(602) Shp. operative		18,772		21,885		26,012
4	(603)Shp. subvencioni		0		0		0
5	(604) Shp. për transferta		4,515		5,516		3,250
6	(606) Transf. tek individët		150		200		100
7	(609)Fondi rezervë		1,300		1,600		1,149
8	(230+231) Shp. kapitale		13,639		11,508		31,176
	Totali	**75,315**	**75,315**	**85,831**	**85,831**	**113,591**	**113,591**

Për vitin 2018.

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se nga totali i të ardhurave totale që do mbulojnë shpenzimet e buxhetit të vitit 2018, të ardhurat e veta zënë 33% ose në vlerën 24,821 mijë lekë ndërsa 67% janë grante specifike dhe grante konkurruese ose në vlerën 50,494 mijë lekë.

Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar për vlerën 7,600 mijë lekë në fakt sipas aktit të rakordimit me degën e thesarit për fund vitin 2018, rezulton se janë realizuar në masën 1,526 mijë lekë, më pak për vlerën 6074 mijë lekë, diferencë e cila ndikon në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuar nga të ardhurat për të njëjtën vlerë.

Për vitin 2019.

Të ardhurat e veta të programuara në buxhetin fillestar, sipas pasqyrës më sipër, zënë 11.7% e buxhetit total ose në vlerën 10,000 mijë lekë ndërsa 88.3% janë grante specifike dhe grante konkurruese ose në vlerën 18,063 mijë lekë.

Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar në buxhetin fillestar për vlerën 10000 mijë lekë në fakt sipas aktit të rakordimit me degën e thesarit për fund vitin 2019, rezulton se janë realizuar në masën 4,004 mijë lekë, më pak për vlerën 5996 mijë lekë, diferencë e cila ndikon në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuar nga të ardhurat për të njëjtën vlerë.

Për vitin 2020.

Të ardhurat e veta zënë 8.4% e buxhetit total fillestar ose në vlerën 9,500 mijë lekë ndërsa pjesa tjetër janë grante specifike dhe grante konkurruese.

Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar për vlerën 9,500 mijë lekë në fakt ato janë realizuar sipas aktit të rakordimit me degën e thesarit për fund vitin 2020, rezulton se janë realizuar në masë për vlerën 5,086 mijë lekë, më pak për vlerën 4,414 mijë lekë, diferencë e cila ndikon në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuar nga të ardhurat për të njëjtën vlerë.

1.2 Mbi dokumentacionin mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Për të gjithë periudhën e audituar, ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Gjatë viteve ushtrimore si rezultat granteve të deleguara jo sipas programimit fillestar si dhe nga mos realizimi i të ardhurave vendore, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime nga miratimi fillestar i buxhetit.

1.3.Dokumentacioni mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID 19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Është rakorduar çdo muaj me degën e Thesarit Korçë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me degën e thesarit Korçë duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitet respektive të realizuar me vendimin e këshillit bashkiak, ose të diktuara nga grantet e deleguara nga pushteti qendror. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore sipas pasqyrës më poshtë:

Realizimi i treguesve të buxhetit në fund të periudhës ushtrimore:

Realizimi i buxhetit për vitet 2018,2019, 2020, sipas situacionit të rakorduar me Degën e Thesarin.

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi Sipas Artikujve Te shpenzimeve	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020	
		Plani	Fakti	Plani	Fakti	Plani	Fakti
1	Llog.600 - Paga	31,070	25,938	39,227	33,578	45,387	35,508
2	Llog 601 - Sig.shoq.Sh	7,030	4,328	7,238	5,657	8,171	5,996
3	Llog 602-Shpenz.opera	13,947	8048	17,752	11,283	19,113	10,264
4	Llogaria 603	0	0	0	0	0	0
5	Llogaria 604	3,355	2,615	3,820	3,817	2,700	2,690
6	Llogaria 606	11,085	11,096	10,590	10,277	13,065	13,061
7	Llogaria 609	800	80	581	0	300	0
8	Llog 230 -231	13,457	4,678	27,898	23,654	57,631	27,475
	TOTALI	**80,744**	**56,783**	**107,106**	**88,266**	**146,367**	**94,994**
	Realizimi në %	**70.3%**		**82.4%**		**65%**	

Për vitin 2018

Buxheti fillestar është për **vlerën 80,744 mijë lekë** ndërsa në fund të periudhës është për **vlerën 56,783 mijë lekë**

Investime janë realizuar në vlerën 4,677 mijë lekë e analizuar sipas objekteve si më poshtë:

Blerje projekti Fv sahat uji 80 mijë lekë

Blerje projekti Rruga Dollna Gorica 155 mijë lekë

Fv sahat uji 1,710 mijë lekë

Blerje pajisje elektrike 148 mijë lekë

Rrethim shkolle Tuminec 396 mijë lekë

Rikons. Shkolle Leska 229 mijë lekë

Mirëmbajtje shkolle Shulin 230 mijë lekë

Kolaudator rruge Gollomboc 40 mijë lekë

Rik. sist. rruge Gollomboc 1,200 mijë lekë
Ndërtim mur mbrojtës Gorice 59 mijë lekë
Rikonst. zyrat e Bashkisë 431 mijë lekë

Fondet të ardhura nga FZHR për likuidimin e objekteve të viteve para 2018 si më poshtë:
Rikonstruk. Rruge Gollomboc 1,200 mijë lekë
Të ardhura të trashëguara sipas akt rakordimit me thesarin në vlerën 17,221 mijë lekë.
Fonde të akorduar nga Ministria e Financave për trajtimin ushqimor të arsimit profesional, në vlerën 0 lekë.
Objektet e investuara janë miratuar me vendime të këshillit të bashkisë.

Për vitin 2019

Buxheti fillestar është për vlerën **107,106mijë lekë** ndërsa në fund të periudhës është për vlerën **88,266 mijë lekë.**
Investime në vlerën 15,887 mijë lekë për objektet si më poshtë:
- Objekti ñRikonstruksion shkolla e mesmeò me vlerë 12,194 mijë lekë me fond të Ministrisë së Arsimit,
-Objekti ñPastrim kanal te II ,IIIò në vlerën 1,026 mijë lekë, me fond të Ministrisë së Mbrojtjes Emergjencat Civile.
Fondet të ardhura nga FZHR për likuidimin e objekteve të viteve para 2019 si më poshtë:
-Objekti ñSist asfaltim rruga G. Madheò në vlerën 2,667 mijë lekë
Fonde të ardhura me VKM për vitin 2019, për objekte si më poshtëò
Të ardhura të trashëguara sipas aktrakordimin me thesarin në vlerën 24,003 mije lekë.
Fonde të akorduar nga Ministria e Financave për trajtimin ushqimor të arsimit profesional, në vlerën 0 lekë.
Objektet e investuara janë miratuar me vendime të këshillit të bashkisë.

Për vitin 2020

Buxheti fillestar është për **vlerën 146,367mijë lekë** ndërsa në fund të periudhës është për **vlerën 94,994 lekë**
Investime në vlerën 27,737 mijë lekë për objektet si më poshtë:
- Objekti ñRikonstruk shkolla e mesmeò me vlerë 12,194 mijë lekë me fond të Ministrisë së Arsimit,
Fonde të ardhura me VKM për vitin 2020, për objekte si më poshtëò
-Objekti ñstudim projekti furnizim me ujëò, në vlerën 15,543 lekë.
Të ardhura të trashëguara sipas aktrakordimin me thesarin në vlerën 18,512 mijë lekë.
Fonde të akorduar nga Ministria e Financave për trajtimin ushqimor të arsimit profesional, në vlerën 0 mijë lekë.
Shtesë nga taksat e ndara tatim mbi të ardhurat personale, në vlerën 699 mijë lekë të akorduara për marrjen e masave anti COVID 19, në për shkolla (602).
Objektet e investuara janë miratuar me vendime të këshillit të bashkisë.

Për vitin 2018,

Shpenzimet e buxhetit janë realizuar në masën 70.3% ose nga 80,744 mije lekë të planifikuara, janë realizuar 56,783 mijë lekë. Me mosrealizim për vlerën 23,961 mijë lekë, sipas zërave si më poshtë:
Në zërin paga dhe sigurime shoqërore, janë realizuar në masën 79.4% ose nga 31,070 mijë lekë dhe realizuar 25,938 mijë lekë të planifikuara.

Në zërin shpenzime operative, janë realizuar në masën 59.6% ose nga 13,947 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 8,048 mijë lekë.
Në zërin investime, buxheti për vitin 2018 është realizuar në masën 34.8% ose nga 13,457 lekë të planifikuara, janë realizuar 4,678 lekë, nga të cilat financim me grant dhe të ardhurat e veta në vlerën 4,678 mijë lekë ose 100%.
Në zërin investime, buxheti i miratuar në fillim viti 2018 është për vlerën 13,639 mijë lekë dhe plani i rishikuar 13,457 mijë lekë ose në pakësim për vlerën 182 mijë lekë, të cilat kanë kaluar për shpenzime operative.

Për vitin 2019.

Shpenzimet e buxhetit janë realizuar në masën 82.4% ose nga 107,106 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 88,266 mijë lekë. Me mosrealizim për vlerën 18,840 mijë lekë, sipas zërave si më poshtë:
Në zërin paga dhe sigurime shoqërore, janë realizuar në masën 85% ose nga 39,227 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 33,578 mijë lekë.
Në zërin shpenzime operative, janë realizuar në masën 63.5 % ose nga 17,752 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 11,283 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 0 mijë lekë ose 0 %.
Në zërin investime, buxheti për vitin 2019 është realizuar në masën 84,8% ose nga 27,898 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 23,654 mijë lekë, nga të cilat financim me grant dhe të ardhurat e veta në vlerën 7,767 mijë lekë ose 32.8%.
Në zërin investime, buxheti i miratuar në fillim viti 2019 është për vlerën 11,508 mijë lekë dhe plani i rishikuar 27,898 mijë lekë ose në rritje për vlerën 16,390 mijë lekë, kjo vjen për investimet të cilat fondet kanë ardhur nga Ministrit e linjës dhe me VKM për objektet si më poshtë:
Objekti ñRikonstruksion shkolla e mesmeò me vlerë 12,194 mijë lekë
Objekti ñPastrim kanale te II ,IIIò në vlerën 1,026 mijë lekë
Objekti ñSist asfaltim rruga G. Madheò në vlerën 2,667 mijë lekë

Për vitin 2020.

Shpenzimet e buxhetit janë realizuar në masën 65 % ose nga 146,367 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 94,994 mijë lekë. Me mosrealizim për vlerën 51,373 mijë lekë, sipas zërave si më poshtë:
Në zërin paga dhe sigurime shoqërore, janë realizuar në masën 78 % ose nga 45,387 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 35,508 mijë lekë.
Në zërin shpenzime operative, janë realizuar në masën 53.7 % ose nga 19,113 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 10,264 mijë lekë, nga të cilat financim me të ardhurat e veta në vlerën 0 mijë lekë ose 0 %.
Në zërin investime, buxheti për vitin 2020 është realizuar në masën 47.7% ose nga 57,631 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 27,475 mijë lekë, nga të cilat financim me grant dhe të ardhurat e veta në vlerën 4,360 mijë lekë ose 15.9%.
Në zërin investime, buxheti i miratuar në fillim viti 2020 është për vlerën 31,333 mijë lekë dhe plani i rishikuar 59,069 mijë lekë ose në rritje për vlerën 27,736 mijë lekë, kjo vjen për investimet të cilat fondet kanë ardhur nga Ministritë e linjës dhe me VKM për objektet si më poshtë:
Objekti ñRikonstruksion shkolla e mesmeò me vlerë 12,194 mijë lekë.
Objekti ñStudim projekt furnizim me ujëò në vlerën 15,542 mijë lekë.
VKB 106 dt 31.12.2018 miratimi i shpenzimeve faktike për vitin 2018.

VKB 11 dt 30.01.2020 miratimi i shpenzimeve faktike për vitin 2019.
VKB 5 dt 09.02.2021 miratimi i shpenzimeve faktike për vitin 2020.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID 19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Nga auditimi u konstatua se për vitin 2020 Bashkia Pustec ka planifikuar për përballimin e situatës së krijuar nga *COVID 19, fonde me burim financimi nga fondi i emergjencës* në vlerën 200 mije lekë. VKB nr 20 dt 25.03.2020 për shumën 100 mije lekë dhe VKB nr 29 dt 26.05.2020 për shumën 100 mijë lekë përkatësisht për blerje pakete ushqimore për familjet me nevojë dhe dezinfektim periodik, si vijon:

Në fakt janë përdorur fonde gjithsej në vlerën 172 mijë lekë si më poshtë :

Urdhër shpenzimi nr. 72 datë 24.07.2020, 89 mijë lekë;
Urdhër shpenzimi nr 145 datë 13.08.2020, 60 mijë lekë;
Urdhër shpenzimi nr 214 datë 09.10.2020, 23 mijë lekë.

Përdorimi i tyre është me objekt:

ñShpenzime paketa emergjence për raste specifikeò është lidhur kontratë me subjektin I. S.ò për furnizim të materialeve të cilat janë lëshuar me faturën e subjektit nr.40, datë 30.04.2020 për vlerën 60 mijë lekë dhe janë bërë hyrje në magazinë me flet hyrje nr 30, datë 30.04.2020 për vlerën 60 mije lekë.

ñMateriale pastrimi për Bashkinë Pustecò është lidhur kontratë me subjektin ñJ. K.ò për furnizim të materialeve të cilat janë bërë hyrje me faturën e subjektit nr.7, datë 04.09.2020 për vlerën 23 mijë lek dhe janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrje nr. 19, datë 04.09.2020 për vlerën 23 mijë lekë.

ñFurnizim ushqimeò është lidhur kontratë me subjektin ñD. B.ò për furnizim të materialeve të cilat janë lëshuar me faturën e subjektit nr.14, datë 07.04.2020 për vlerën 89 mijë lekë dhe janë bërë hyrje në magazinë me flet hyrje nr 3, datë 07.04.2020 për vlerën 89 mijë lekë.

Dhurime dhe donacione janë si me poshtë :

-Nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë (DPRMSH), bashkia Pustec ndihma ushqimore, **në vlerën 24 mijë lekë.** Fletëdalja e furnitorit (DPRMSH) është e shoqëruar me fletëhyrjen e bashkisë Pustec, rezulton se Fletëdalja nr. 204, datë 21.05.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.22, datë 14.09.2020 për ushqimet në vlerën 9 mijë lekë. Fletëdalja e furnitorit (DPRMSH) është e shoqëruar me fletëhyrjen e bashkisë Pustec, rezulton se Fletëdalja nr. 267, datë 05.06.2020 është shoqëruar me fletëhyrje nr.23, datë 14.09.2020 për ushqimet në vlerën 15 mijë lekë.

-Shtesë nga taksat e ndara TAP, në vlerën 699 mijë lekë të akorduara për marrjen e masave anti COVID 19, në shkolla (602) për blerjen produkteve të higjienës personale 83 mijë lekë. Me VKB nr. 20, datë 25.03.2020 është miratuar për tu përdorur fondi me objekt ñBlerje materiale për marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së COVID 19 në institucioneò është lidhur kontratë me subjektin ñD. B.ò për furnizim të materialeve të cilat janë lëshuar me faturën e subjektit nr.14, datë 07.04.2020 për vlerën 89 mijë lekë dhe janë bërë hyrje në magazinë me flet hyrje nr 3, datë 07.04.2020 për vlerën 89 mijë lekë.

Mbi dokumentacionin mbi nivelin e faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore.

Nga të dhënat, konstatohet se totali i faturave të palikujduara në fund të vitit 2020, të llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, llogarisë (401-408) ñFurnitor e llogari të lidhura me toò, detyrime të tjera në llog (467) ñKreditorë të ndryshëmò, paraqitet në vlerën 3470 mije lekë, ose 2.4 % e vlerës së buxhetit të vitit 2020.

Me datë 30.06.2021, konstatohet se totali i faturave të palikujduara, të llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, llogarisë (401-408) ñFurnitor e llogari të lidhura me toò, detyrime të tjera në llog (ñKreditorë të ndryshëmò, paraqitet në vlerën 33,606 mije lekë, në totalin e tyre. Vendime Gjykate janë për vlerën 0 lekë.-

Dokumentacioni mbi çeljen dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;
Nga të dhënat e paraqitura nga drejtoria e financës rezulton se Bashkia Pustec për periudhën objekt auditimi ka përfituar fonde nga FZHR në total 11,448 mijë lekë si vijon:
Për vitit 2018, është bërë likuidimi i plotë i vlerës së objekteve të financuar nga FZHR në periudhën para vitit 2018, në vlerën 1,200 mijë lekë.
Për vitit 2019, është bërë likuidimi i plotë i vlerës së objekteve të financuar nga FZHR në periudhën para vitit 2019, në vlerën 2,667 mijë lekë.
Për vitit 2020, është bërë likuidimi i plotë i vlerës së objekteve të financuar nga FZHR në periudhën para vitit 2020, në vlerën 7,581 mijë lekë.

1.4. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhës së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore fuqi dhe detyrimet tatimor.

***1. Titulli i gjetes**: Punë e pa mjaftueshme e sektorit të taksave dhe tarifave vendore për parashikimin dhe arkëtimin e taksave nga biznesi dhe taksapaguesit familjar.*

Situata:
Në Bashkinë Pustec për periudhën e objekt auditimi ka funksionuar Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore me strukturë të rregullt, e cila është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 104 datë 24.12.2019, me miratimin e strukturës organike të bashkisë. Në vijim paraqesim evidencën e gjendjes së bizneseve dhe ndryshimet e ndodhura si regjistrimet e reja, bizneset që kanë mbyllur aktivitetin dhe gjendja në fund të periudhës.
Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për periudhën 01.01.2018 deri 31.12.2020.

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2018	20	2	2	20
		2019	20	2	4	18
		2020	18	3	2	19
2	Biznesi Madh	2018	1			1
		2019	1			1
		2020	1			1
(1+2	Gjithsej	2018	21	2	2	21
		2019	21	2	4	19
		2020	19	3	2	20

Sa më sipër konstatohet se numri i bizneseve në total është thuajse i pa lëvizshëm, për periudhën objekt auditimi 2018-2020, janë regjistruar 8 biznese të reja, kurse kanë mbyllur aktivitetin gjithsej 7 biznese.
Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizmi i të ardhurat për taksat dhe tarifat vendore për periudhën .01.01.2018 dhe 31.12.2020, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

. Në /lekë

Nr.	Lloji i Taksës	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020

		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9
I	Te ardhura nga Tatimet									
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin		21,775						41,680	
II	Te ardhura nga Taksat									
2	Taksa mbi B. Vogël									
3	Taksa e Pasurisë, ndërtese	896,200	156,550	17	896,200	439,923	49	896,200	518,851	58
4	Taksa mbi token Bujqësore	1,189,300	243,800	20	1,189,300	278,004	23	1,189,300	262,783	22
5	Takse mbi rregj e Automjete	500,000	404,248	81	500,000	368,508	74	500,000	321,497	64
6	Taksa e ndik të nd mbi infrast	500,000	-		1,000,000	1,538,514	154	1,000,000		
7	Takse Tabele	1,800	3,250	181	10,000	1,560	16	10,000	10,440	104
8	Takse hoteli									
9	Takse Parkimi									
10	Takse për hapësira publike									
11	Takse trualli	48,080	2,490	5	50,000	44,493	89	60,000	49,345	82
III	Te ardhura nga Tarifat									
12	Tarife Pastrimi	1,700,000	365,100	21	2,600,000	709,900	27	1,900,000	693,740	37
13	Tarifëshërbim te tjera publike									
14	Tarife leje transport.									
15	Tarife vend banor/gj CIVILE									
16	Tarife urbanistike									
17	Tarife rregj biznes i Ri									
18	Tarife ndriçimi rrugor	479,200	219,200	46	1,154,500	307,200	27	1,154,500	279,800	24
19	Te ardhura te tjera	1,544,800	106,750	7	1,800,000	100,337	6	1,940,000	220,850	11
20	Tarife çertifikimi mishi									
IV	Te ardhura te tjera									
21	Qera trualli	740,620	-		800,000	189,000	24	800,000	1,397,781	175
22	Shitje Pase&privatiz banese									
23	Qera kullote									
24	Tarifë uji i pijshëm									
25	Te ardhura tendera									
26	Gjoba.							50,000	25,707	51
27	Takse Vule									
28	Qera ndertese									
29	Dhurata, sponsoi & Garanci.									
30	Te ardhura te tjera									
	GJITHSEJ (I+II+II+ IV)	**7,600,000**	**1,523,163**	**20**	**10,000,000**	**3,977,439**	**40**	**9,500,000**	**3,822,474**	**40**

Për vitin 2018, ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksat, e cila është programuar në masën 6,076 mijë lekë, realizuar në masën 1,523 mijë lekë ose 20%, -Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit, e cila është realizuar në vlerën 365 mijë lekë ose në masën 21%.

Për vitin 2019, ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksat, e cila është programuar në masën 6,022 mijë lekë, realizuar në masën 3,977 mijë lekë ose 40%, -Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit, e cila është realizuar në vlerën 709 mijë lekë ose në masën 27%.

Për vitin 2020, ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksat në total, e cila është programuar në masën 9,500 mijë lekë, realizuar në masën 3,822 mijë lekë ose 40%,

-mos realizim i të ardhurave nga taksa mbi Taksën e Tokës Bujqësore, e cila është programuar në masën 1,189 mijë lekë, realizuar në masën 262 mijë lekë ose 22%, mos realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila është programuar në masën 1,000 mijë lekë, realizuar në masën 0 lekë.

-Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit, e cila është realizuar në vlerën 693 mijë lekë ose në masën 37%.Të ardhurat janë rakorduar me Degën e Thesarit çdo muaj dhe në mënyrë progresive.

Nga auditimi i të dhënave të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, rezulton se gjendja e debitorëve për periudhën 2018 -31.12. 2020, paraqitet sipas pasqyrës si vijon:

Gjendja debitorë për vitin 2018									
NJA	**EMËRTIMI**	**Debitor 31.12.2017**		**Shtuar viti 2018**		**Arkëtuar viti 2018**		**Mbetja 31,12,2018**	
		Nr	**Vlerë**	**Nr**	**Vlerë**	**Nr**	**Vlerë**	**Nr**	**Vlerë**
Pustec	Subjekte	17	251,070	20	387,019	10	120,910	28	517179
	familjarë	947	4,215,076	280	3,430,885			1,227	7,645,961
Gjendja debitorë për vitin 2019									
NJA	**EMËRTIMI**	**Debitor 31.12.2018**		**Shtuar viti 2019**		**Arkëtuar viti 2019**		**Mbetja 31.12.2019**	
		Nr	**Vlerë**	**Nr**	**Vlerë**	**Nr**	**Vlerë**	**Nr**	**Vlerë**
Pustec	Subjekte	28	517,179	9	139693	18	306,461	16	350,412
	familjarë	1227	7,645,961	60	3,574,610	2	5790	1296	11,214,381
Gjendja debitorë për vitin 2020									
NJA	**EMËRTIMI**	**Debitor 31.12.2019**		**Shtuar viti 2020**		**Arkëtuar viti 2020**		**Mbetja 2020**	
		Nr	**Vlerë**	**Nr**	**Vlerë**	**Nr**	**Vlerë**	**Nr**	**Vlerë**
Pustec	Subjekte	16	350,412	3	50971	8	175,462	10	225,921
	familjarë	1296	11,214,381	63	3,679,319	11	80,481	1355	14,813,219

Burimi i te dhënave sektori i taksave dhe tarifave vendore.

Lista analitike e debitorëve të biznesit të vogël dhe të biznesit të madh, për periudhën e viteve 2018 dhe 2020, nuk u printua nga ana e grupit të auditimit për shkak te volumit të madhe.

Nga Sektori i të Ardhurave Bashkia Pustec dhe në Njësitë Administrative, për mos pagimin në afat të detyrimit tatimore për taksat dhe tarifat vendore në shkallë Bashkie Pustec,vlera e subjekteve debitorë deri në datën 31.12.2020 është në vlerën 15,039,140 lekë, e cila përfaqëson:

-10 subjektet e biznesit të vogël e të madh në vlerën 225,921lekë

-1355 familjarë janë debitorë për taksat e tokës dhe tarifat familjare në vlerën 14,813,219 lekë

Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, nga bizneset, nga ana e drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore, u janë bërë njoftim subjekteve dhe nuk janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, ZRPP/ASHK për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit. Nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008ò Për Procedurat tatimore në R.SHò ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Për veprime dhe mosveprime ngarkohen me përgjegjësi: znj. E. A., me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore periudha 2019 –2020 dhe z. Q. T., me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore periudha 2019 –2020.

Kriteri:

Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, Kreut XI-*"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara",* të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimoreò, të ndryshuar. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 104 datë 24.12.2019.

Impakti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Pustec **në vlerën15,039,140lekë.**

Shkaku: Mos zbatimi i procedurave të plota në arkëtimin e debitorëve nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Sektori i Taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pustec, bazuar në nenin 70 pika 3 ñ*E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor*ò, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat tatimore në R.SHò, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të periudhës në vlerën 15,039,140 **lekë**, si më poshtë vijon**:**

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore Republikan e Shqipërisëò me ndryshime.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 ñ*Mospagimi taksave dhe tatimeve*ò.

2. Titulli i Gjetjes: *Mangësitë e konstatuara në dhënien me qira të aseteve të Bashkisë apo Njësisë Administrative dhe arkëtimi i të ardhurave nga qiraja dhe përdorimi i tyre.*

Situata:

Bashkia Pustec ka lidhur Kontratë Qiraje nr. 29108, datë 09.04.2008, me Subjekti ñT. A. òSHA, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik në pronësi të ish-Komunës Liqenas (sot Bashkia Pustec) për 300 m^2 për ndërtim të stacionit të antenave, me afat 10 vjeçar (09.04.2008 deri 09.09.2017), me të drejtë rinovimi çdo vit, me vlerë 300,000 lekë/vit,Kontratë Qeraje nr. 28/17, datë 09.04.2017, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik për 205 m^2 për ndërtim të stacionit të antenave, me afat 10 vjeçar (09.04.2017 deri 09.04.2026), me të drejtë rinovimi çdo vit, me vlerë 191,500 lekë/vit dhe Kontratë Qeraje nr. 66/08, datë 12.11.2009, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollosor publik për 150 m^2 për ndërtim të stacionit të antenave, me afat 10 vjeçar (12.11.2009 deri 12.11.2018), me të drejtë rinovimi çdo vit, me vlerë 150,000 lekë/vit, vlerat e kontratës janë llogaritur sipas VKM nr. 391, datë

21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotaveò, lidhjes 2, pika 6 *"Për vendosje antene"*
Nga të dhënat e marrë në zyrën e e financës, rezulton se subjekti ñA. T.ò SHA nuk ka likuiduarpër kontratënnr 1005, datë 15.06.2011, për kontratën nr. 66/08, datë 12.11.2009, detyrimin e viti 2020-2021 për vlerën **300,000 lekë,** detyrim gjithsej i palikujduar në vlerën **300,000 lekë** , është shkelje e disiplinës financiare me **dëm për buxhetin të Bashkisë Pustec,** veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me kushtet e kontratave Kontratës së Qirasë me nr. 29108, datë 09.04.2008, me Subjekti ñT. A. òSHA, nenin 12,ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollinò si dhe ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 ñKodi Civilò, neni 801 e vijues, referuar nenit 815, citohet ñQiramarrësi që është në vonesë për të kthyer sendin, detyrohet tõ japë qiradhënësit pagesën e caktuar deri në dorëzim, përveç detyrimit për të shpërblyer dëmin përkatësò

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

- ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 ñPër transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendoreò, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, dhe ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 ñKodi Civilò, neni 801 e vijues,

Impakti

Mungesë të ardhurash për bashkinë Puste me pasoj dëm ekonomik në vlerën 300,000 lekë.

Shkaku

Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin e detyrimeve të cilat rrjedhin nga kontratat.

Rëndësia:- E Lartë.

Rekomandimi:

Bashkia Pustec të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 300,000 lekë** nga subjekti ñT. A. ò SHAduke llogaritur edhe penalitetet përkatëse.

2.2. Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitet 2019-2020 nga njësia shpenzuese ñAparati i Bashkisë Pustecò për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, VKM nr.248, datë 10.04.1998 pika 3, ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001, UMF nr.26, datë 27.12.2007 ñPër disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 ñPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qëndrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huajò, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò. Lidhur me

operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Korçë për vitin ushtrimor 2019 me shkresë përcjellëse nr. 788 prot., datë 27.07.2020 dhe për vitin ushtrimor 2020 me shkresën nr. .777 datë 11.06.2021. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Pustec dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori Ekonomik. Pra në këtë rast nuk ka delegime të këtyre detyrave.

1.- Titulli i gjetjes *Hartimi dhe plotësimi i pasqyrave financiare të viteve 2019 dhe 2020 është bërë jashtë afatit ligjor.*

Situata:

Pasqyrat financiare të viteve 2019 dhe 2020 (bilanci), janë mbyllur jashtë afatit ligjorë, konfirmuar me shkresën me shkresë përcjellëse nr. 788 prot., datë 27.07.2020, për vitin ushtrimor 2019 dhe shkresën nr. .777 datë 11.06.2021. për vitin 2020, të konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të viteve 2019-2020 me anekset përkatëse, *pra me 3 muaj vonesë,* veprime të cilat ***mbajnë përgjegjësi: z. C. N., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Financës.***

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

- ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollitò sipas shkronjës (d)[9] e pikës 4 e nenit 9, dhe shkronjës (b)[10] e pikës 2 të nenit 12,; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, pika 118[11].

Impakti:

Mos hartimi në afat i pasqyrave financiare, krijon risk në drejtim të konfirmimit të pasqyrave financiare dhe mbivendosje të drejtimit në kontrollet e pasqyrave financiare.

Shkaku:

Mbingarkesa në kryerjen e detyrave funksionale dhe pamundësia për menaxhimin e situatës së konsolidimit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

1. Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos mbylljes në afat të pasqyrave financiare për vitet 2019 dhe 2020, duke evidentuar personat përgjegjës dhe të marrë masë ndaj tyre në zbatim të shkronjës (e) të nenit 71-*Kundërvajtje administrative,* të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SHò, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016.
2. Në pasqyrat financiare të përshkruhet qartë baza mbi të cilën janë përgatitur, duke referuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për klasifikimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Përgjegjësia për raportim në çdo kohë të jetë e dokumentuar jo nëpërmjet shkresës

[9] Planifikimin, menaxhimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar të veprimtarisë së njësisë publike

[10] raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave

[11] Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajt mars të vitit pasardhës.

përcjellëse të dërgimit të pasqyrave, por evidentohet në përgjegjësi të plotë në kapakun e pasqyrave financiare, se kush janë hartuesit dhe drejtuesit.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2018-2020 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve në kartelat e llogarive të librit të madh.

➢ ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➢ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti nuk është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program ñExcelò
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike nuk janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, magazinës, të pagave etj. si dhe janë mbajtur ditarët për llogaritë kreditore e debitorë. Përsa i përket sistemimeve janë evidentuar në kartelat kontabël të llogarive përkatëse dhe artikujve kontabël të prerë për veprime të ndryshme janë evidentuar në librin e veprimeve të ndryshme. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vlerës, personat qe kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhënat te nevojshme qe i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu : Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, lis pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➢ ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiarë të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar për vitet 2019 dhe 2020.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2020.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet nuk janë rregjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë regjistruar në momentin e çeljes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, ndërsa detyrimet nuk janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra nuk janë të paraqitura të plota në bilanc.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.
Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të deri diku të përshtatshme dhe të përshkruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura .
Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë, por jo në sasinë e duhur.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2020 rakordon me tepricat në mbyllje të vitit 2019.**
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2019-2020 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike;
Totali i Aktivit për vitin 2020 është 241,267,649 lekë dhe për vitin 2019 është 206,760,011 lekë, i paraqitur në aneksin nr. 1 dhe i zbërthyer në llogari si vijon:

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2019-2020

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; ***llogaria 520*** ñ*Disponilitete në Thesar"*, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën debitorë **20,635,126 lekë** për vitin 2019 dhe në vlerën debitorë **29,503,586 lekë** për vitin 2020
Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Korçë, kjo llogari ***është*** për vlerën debitorë **20,635,126 lekë** për vitin 2019 dhe në vlerën debitorë **29,503,586 lekë** për vitin 2020. Këto veprime janë përfshirë edhe me Formatin nr.3 ñPasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkteò.të paraqitur më poshtë:

Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
(b)	(c)	(1)	(2)
I	**VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT**	**10,415,096**	**16,108,404**
1	**Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente (+)**	89,185,659	81,491,957
2	**Arkëtime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor**	6,353,902	5,193,856
	Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	4,523,494	3,948,097
	Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)	100,000	29,342
	Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)		
	Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		
	Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
	Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	368,679	1,216,417
	Te tjera, arketuar(+)	1,361,729	
3	**Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente**	-65,222,567	-65,383,553
	Per detryrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
	Për detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-64,828,646	-6,439,680
	Pagesat për mjetet ne ruajtje(-)	-393,921	-804,873
	Interesi I paguar(-)		
	Tatime te paguara(-)		

	Te tjera te paguara (-)		
II	**VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE**	7,200,939	1,826,938
	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+)	34,676,023	25,480,754
	Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
	Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
	Te hyra nga interesat e huadhënies dhe nen huadhënies(+)		
	Pagesa përdetyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
	Përdetyrime e Investime të viti ushtrimor(-)	-27,475,084	-23,653,816
	Huadhënie e Nën huadhënie(-)		
	Pjesëmarrje në kapitalin e vet(-)		
	Dividente të paguar(-)		
III	**TRANSFERTA E TE TJERA**	-8,747,575	-4,325,188
	Derdhje e Transferime të të Ardhurave në Buxhet(-)	-1,800	- 86,368
	Transferime ne buxhet te Fondevetë pa përdorura(-)	-6,055,775	-421,820
	Lëvizje e brendshme e transferta te tjera(+-)	-2,690,000	-3,817,000
IV	**Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare**	8,868,460	-5,854,737
V	**Teprica ne fillim te vitit ushtrimor**	20,635,126	26,489,863
VI	**Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor**	29,503,586	20,635,126

Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Korçë, kjo llogari ***është*** për vlerën debitorë **20,635,126 lekë** për vitin 2019 dhe në vlerën debitorë **29,503,586 lekë** për vitin 2020.
Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Korçë për vitin 2020, është e analizuar si vijon:

Nr.	Llogaria	2020
1	Llogaria 520 ñDisponibilitete në thesarò	29,503,586
2	Llogaria 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò	2,098,102
3	Llogaria 85òRezultati i veprimtarisë së ushtrimitò	27,405,484

Në këtë rast, llogaria 520 ñ*Disponilitete në Thesar"* është ***e rakorduar me të dhënat*** e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, pasqyrohet saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 29,503,586 lekë, ***në përputhje*** *me kërkesat e UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.*

2.Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë **31 "Materiale",** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019 paraqitet në vlerën 3,092,982 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 20,773,709 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe sektorit të financës.
-Gjendja e llogarisë **32 "Inventar i imët"** në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2019 paraqitet në vlerën 5,676,190 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 10,417,959 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit dhe përgjegjësit të financës

1. **Titulli gjetjes:**Mos pasqyrimi në kontabilitet i debitorëve familjarë dhe subjekteve private, për mos pagimin e taksave dhe tarifave vendorenë vlerën prej **15,039 mijë**.

Situata:
Llogaria **468 "Debitorë të ndryshëm"** për vitin 2020, paraqitet në vlerën **129,768** lekë për 33 raste, të cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Konstatohet së vlera **129,768** lekë janë detyrime përpara vitit 2015 të trashëguara nga ish komunat. i ciliështë detyrim i pa definuar, pa dokumentacionin përkatës për t`u paraqitur si detyrim ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera, i mbartur, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur, *në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 6.*
Sipas akt rakordimit të mbajtura nga sektori i të ardhurave me degën e thesarit, debitorët e subjekteve taksapagues privat dhe familjar, janë në vlerën prej **15,039 mijë** lekë gjendje 31.12.2020. Nga analiza e llogarisë 468 **"Debitorë të ndryshëm" konstatohet se** vlera prej **15,039 mijë** lekë nuk është pasqyruar në kontabilitet. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò*Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" , aneksi 1, pika 3.3.*
Kriteri:
Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;
Ligji 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò,
Urdhëri nr.64 datë 22.07.2014 ñ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 ñTë ardhuratò, pika 8 e standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.
UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò, kapitulli II, pika 6.
Ndikimi/Efekti:
Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitet 2019-2020 të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò, në vlerën prej 15,039 mijë lekë
Shkaku:
Mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi:
- Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në fundë të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 15,039 **mijë lekë** sipas evidencave të Sektorin të të Ardhurave Vendore.
- Sektori i Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

3. Mbi kontabilizimin e llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò dhe llogarisë 401- 408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò si dhe llogarisë 467 ñKreditorë të ndryshëmò.

Situata:
Nënrubrika, të tjera aktive afatshkurtra, gjendja e llogarisë **486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme",** më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 6,393,315 lekë, kurse më 31.12.2020 paraqitet në

vlerën **1,437,029** lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve. Përbërja analitike është si në aneksit nr. 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar pasi llog. 486 ñ*Shpenzime të periudhave të ardhshme*ò përfaqëson vlerën kundër parti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit.
Vlera debitorë e kësaj llogarie, ***nuk është e kuadruar*** me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të cilave është në shumën totale **2,033,221 lekë** sipas llogarive dhe as është e analizuar sipas llojeve të detyrimeve të pa paguara si më poshtë vijon:
-Llogaritë 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò për vlerën kontabël për 435,624 lekë dhe llogaria 467 ñ*Kreditorë të ndryshëm*ò për vlerën kontabël 1,597,597 lekë. *Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.*

Kriteri:
Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi ï 1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik. Ligjin 10296 datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò

Ndikimi/Efekti:
Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:
- Bashkia Pustec, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò dhe kundër partisë së saj 467 ñKreditorë të ndryshëmò
- Sektori i financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet të llogarisë 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò duke pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 **"**Kreditorë të ndryshëmò në pasiv të bilancit, detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore si dhe nga detyrimet kontraktore të cilave i ka kaluar afati 60 ditor në vlerën **435,624 lekë.** Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

II. Rubrika, aktivet afatgjata.

4. **Titulli gjetjes:***Mbi kontabilizimin e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime ".*

Situata:
1.Nënrubrika, aktive afatgjata jo materiale, gjendja e llogarisë **202 "Studime dhe kërkime",** më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 2,558,433 lekë, ndërsa më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 18,399,892 lekë, me diferencë në rritje në vlerën 15,841,459 lekë e cila përfaqëson shtimin e tre projekteve për vitin 2020, (Për 2 Blerje projekti studim Uji i Pijshëm dhe Oponence teknike KUZ, Bashkia Pustec).
Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:**

a)Vlera 2,558,433 **lekë**, i përkasin 20 projekteve për investimet e kryera, për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, sipas aneksit në vijim. Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, veprimi është në mos respektim të dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ñPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, pika ñcò, nën pika ñbò, e analizuar sipas aneksit nr.4, pika 3, për projektet, studimet e kërkime dhe vlerat përkatëse, gjendje më 31.12.2020 bashkëlidhur raportit.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

- ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareñ neni 6,9 dhe 10 Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò dhe konkretisht standardin kombëtar të kontabilitetit nr.5 *"Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale"* paragrafët 10 deri 19 dhe pikat 46 deri 55 të këtij standardi. - UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ñPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, pika ñcò, nën pika ñbò

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiar për vitin 2020 të llogarisë 202 ñStudime e kërkimeò.

Shkaku:

Mos zbatim i ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareñ neni 6,9 dhe 10 Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi:

- Sektori i Financës në Bashkinë Pustec të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 ñ*Studime dhe Kërkime"* dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

2.Nënrubrika, aktive afatgjata materiale,

-Llogaria **210 "Toka, Troje, Terrene"**për vlerën kontabël historike ***0 lekë***. Kjo llogari, periudhës objekt auditimi vit 2018-2020, nuk ka pasur shtesa ose pikësime.

-Gjendja e llogarisë **211 "Pyje kullota plantacione"**në datën 31.12.2019, paraqitet në vlerën 1,793,836 lekë, në 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 1,793,836 lekë e pa ndryshuar. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite. Kjo llogari është e analizuar në mënyrë kontabël sipas të dhënave si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi	Kosto Historike
1	Punim gjelbërim sistem i territoreve publike Komuna Pustec	1,793,836
	Shuma	1,793,836

-Gjendja në llogarinë **212 "Ndërtime e konstruksione"** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 38,655,860 lekë, më 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie rezulton 44,101,936 lekë e cilat

përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet janë vetëm për vlerën e amortizimit.*(Më hollësishtllogaria 212 **"Ndërtime e konstruksione"** është e analizuar sipas aneksit nr.5, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit).*

-Gjendja në llogarinë **213 "Rrugë, rrjete vepra ujore"**, më 31.12.2019, paraqitet në vlerën 112,909,700 lekë, më 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie rezulton 96,980,075 lekë, e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës, peksimet janë vetëm për vlerën e amortizimit. *(Më hollësisht llogaria 213 **"Rrugë, rrjete vepra ujore"** është e analizuar sipas aneksi nr.6, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit).*

-Gjendja e llogarisë **214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"** më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 2,449,113 lekë, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 5,764,200 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe peksimet nga amortizimi. *(Më hollësisht llogaria **214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"** është e analizuar sipas aneksi nr.7, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit).*

-Gjendja e llogarisë **215 "Mjete transporti"** më 31.12.2019 në vlerën 8,053,223 lekë, më 31.12.2020 në vlerën 7,180,821 lekë. *(Më hollësisht llogaria **215 "Mjete transporti"** është e analizuar sipas aneksi nr.8, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit)*

-Gjendja e llogarisë **218 "Inventar ekonomik",** më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 678,459 lekë, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 468,791 lekë,*(Më hollësisht llogaria **218 "Inventar ekonomik"** është e analizuar sipas aneksi nr.9, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit.)*

Për vitin 2019 dhe vitin 2020 gjendja e llogarisë **219 "Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara",** amortizimi i AQT-ve nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto paraqiten në formatin 7/a dhe 7/b(gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 ñPër tatim mbi të ardhurató, i ndryshuar; si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019ò Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò. (*Më hollësisht trajtuar në pasqyrën aneks nr. 10 pika 3, llogaritja e amortizimit bashkëlidhur raportit të auditimit.)*

5 . <u>Titulli gjetjes:</u>Mungesa e kartelave kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

<u>Situata:</u>Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën neto) për vitin 2020 në vlerën **156,289,659** lekë dhe për vitin 2019 në vlerën**164,540,191** lekë nuk është paraqitur i plotë. Sipas inventarit **kontabël të aktiveve afatgjata materiale** gjendja e llogarive: ***210"Toka, Troje, Terrene"*** është në vlerën 0 lekë; llogaria ***211"Pyje, Plantacione"*** në vlerën 1,793,836 lekë, llogaria ***212 "Ndërtesa Konstruksione"*** në vlerën 44,101,936 lekë; llogaria ***213"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*** në vlerën 96,980,075 lekë; llogaria ***214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** në vlerën 5,764,200 lekë. Sa me sipër pasqyrimi i gjendjes kontabël i aktiveve **nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull**, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë

viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.
Nga Dega e Thesarit Korçë nuk është kërkuar regjistri aktiveve për regjistrimin në sistemin informatikë financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një data basë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Pustec, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre, veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò kapitulli III, pika 30.
Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos ñcertifikuarò vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Kriteri

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò kapitulli III, pika 30.

Impakti

Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos ñcertifikuarò vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Shkaku

- Nga Sektori Ekonomik nuk janë marrë masat e nevojshme që për këto aktive të mbahen kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi

Sektori Ekonomike në Bashkinë Pustec të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit, ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 ñHuadhënie e nën huadhënieò dhe 6 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetëò, nuk janë kryer veprime të tilla, për rrjedhojë gjendja e tyre në pasqyrat e pozicionit financiar paraqitet me zero.

6. Titulli gjetjes: Mos pasqyrimi në llogarinë 26 ñAktive afatgjata financiareò i aksioneve të ñUjësjellës Kanalizime Pustec Sh.a me vlerë 58,800,000 lekë

Situata:

Llogaria 26 ñ*Aktive afatgjata Financiare*ò,sipas pasqyrës financiare paraqitet me vlerë zero lekë për periudhën objekt auditimi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Pustec, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 13/09/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Pustec SHA me NUIS ñL74004003Bò e cila është shoqëri aksionare me objekt ñShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e

kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyreò. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqiò. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 58,800 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 58,800,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalitme 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pustec në ñUjësjellës Kanalizime Pustec SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019-2020, më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialëò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.

Kriteri:

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Urdhrin e MF nr. 64, datë 22.7.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabiliteti të Përmirësuarò, me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materialeò, pika 55,56 dhe 57.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiare viti 2020, të llog 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò, gjendje kjo e nën vlerësuar me vlerë 58,800,000 lekë.

Shkaku:

Mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia:*I lartë*

Rekomandimi:

Rekomandimi:

- Bashkia Pustec, nëpërmjet Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek ñUjësjellës Kanalizime Pustec Sh.a me vlerë 58,800,000 lekë, në debi të llog. 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.

1.Nënrubrika, llogari të pagueshme, gjendja e llogarive të 401-408 ñFurnitorë dhe llogari te lidhura me toò, të 42 ñPersoneli e llogari të lidhura me toò, -të 431 ñDetyrime ndaj shtetit për tatim-taksaò, të 435 ñDetyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreò, të 436 ñDetyrime ndaj shtetit për sigurime shoqëroreò, të 467 ñDebitor të ndryshëmò nuk janë të barabarta me gjendjen e llogarisë 4342 ñOperacione me shtetinò e pasqyruar në aktiv të PF në vlerën 4,316,047 lekë.

- ***Gjendja e llogarisë 4342*** ñTë tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2020)ò në aktiv të pasqyrave financiare (Formati nr.1), paraqitet në vlerën 4,316,047 lekë, në pasiv të pasqyrave financiare (Formati nr.1), paraqitet në vlerën 5,852,976 lekë pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar. Pasi kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2019 të cilat trashëgohen në vitin 2020, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò për vlerën 435,624 lekë, llog.42 ñDetyrime ndaj personelitò për vlerën 2,744,772 lekë, llog.431 ñDetyrime ndaj shtetit për tatim taksaò për vlerën 120,437 lekë, llog.435 ñSigurime shoqëroreò për vlerën 841,346 lekë, llog. 436

ñSigurime shëndetësoreò për vlerën 435,624 lekë dhe llogarinë 467 ñDebitor të ndryshëmò për vlerën 1,597,597 lekë

Përsa më sipër, paraqitja e llogarisë 4342 "Operacione me shtetin" është nënvlerësuar për vlerën 1,536,929 lekë. Paraqitja e llogarisë *4342 "Operacione me shtetin" është në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50. Në mënyrë të detajuar paraqitja e llogarisë vijon;*

-Gjendja e llogarisë 42 **"Detyrime ndaj personelit**ò në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 2,744,772 lekë e cila paraqet detyrimet për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2020.

-Gjendja e llogarisë ***431 "Detyrime ndaj shtetit tatim taksa***ò në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 120,437 lekë detyrimet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për muajin dhjetor 2020.

-Gjendja e llogarisë ***435 "Sigurime shoqërore***ò në 31.12.2020 paraqitet në vlerën 841,346 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore për muajin dhjetor 2020.

-Gjendja e llogarisë ***436 "Sigurime shëndetësore***ò në 31.12.2019 paraqitet në vlerën 113,200 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shëndetësore për muajin dhjetor 2020.

Krahasuar me listë pagesat e muajit dhjetor të vitit 2020 dhe me evidencën e shpenzimeve të muajit janar të vitit 2020, vlerat e llogarive 42, 431, 435, 436 rakordojnë dhe janë të njëjta me përmbledhësen e listë pagesave dhe evidencën e shpenzimeve.

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2020
1	Paga Personeli llogaria 42	2,744,772
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	120,437
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	841,346
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	113,200
5	Furnitorëllogaria.401-408	435,624
6	Kreditore te ndryshëm llogaria. 467	1,597,597
	TOTALI	5,852,976

7. Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò.

Situata:

Llogaria 466 **"Kreditorë për mjete në ruajtje",** më 31.12.2019, paraqitet në vlerën 2,123,344 lekë, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 2,098,102 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:**

Për vitin 2020 nga sektori i financës ka të dokumentuar ngurtësimet gjatë vitit 2020 në vlerën 2,098,102lekë për 19 subjekte. Gjatë vitit 2020 shesta janë në vlerën **368,679 lekë** dhe likuidimet e kryera në vlerën **393,921** lekë për 3 subjekte. Sipas akt rakordimeve midis Bashkisë dhe degës së thesarit.

Si përfundim konstatohet se: Në llogarinë **466 "Kreditorë për mjete në ruajtje", më 31.12.2020 paraqitet në vlerën** 2,098,102 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh, për objekte të përfunduara dhe në proces.

Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:**

a)Në pasqyrat e pozicionit financiar llogaria 466, kreditorë për mjete në ruajtje paraqitet në vlerën 2,098,102 lekë, ndërsa në mënyrë analitike paraqitet në vlerën 2,043,102**lekë për 19 subjekte, me diferencë më pak në vlerën 55,000 lekë e** i korrespondon taksës së pullës në fund të periudhës 2020

b)Për 19 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 2,043,102 lekë, *sipas aneksit nr.11, pika 3,* nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.
Veprimet e mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",* Kap. III, pikat 30, 50.
- pika 30."Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet"
- Pika 50. "Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuara sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)",

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 ñ*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*ò i ndryshuar, Kap. II, pika 10.
- Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.
Kriteri:
Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: *UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 30, 50.*
Ndikimi/Efekti:
Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò
Shkaku:
Mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi:
- Sektori i Financës të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 ñ*Kreditore për mjete nën ruajtje*ò, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

8.- Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 401- 408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò si dhe 467 ñKreditorë të ndryshëmò.

Situata:

Llogarisë 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 435,624 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 435,624 lekë, e pa ndryshuar. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 10 fatura të palikujduara të krijuara gjatë viteve 2011-2017 për mallra dhe shërbime në vlerën 435,624 lekë *konstatohet se vlera* 435,624 *lekë është pozicionuar në mënyrë të gabuar në llogarinë 401-408 pasi ka kaluat afatin 60 ditor për likuidimin e vlerës çka ka sjell një mbivlerësim të llogarisë në vlerën* 435,624 lekë. dhe një nënvlerësim të llogarisë 467ñKreditorë të ndryshëmò në vlerën 435,624 lekë, për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve.

Kriteri:

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me, UMF nr.2 datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò pikën 62 dhe 102, me Udhëzimin nr.2 datë 09.01.2015, pika 6.1 ñVendimet gjyqësoreò, me Udhëzim e MFE nr. 8,datë 9.3.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò **Aneksi 1** ñAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikò **Pika 3.3/c.d** ñTrajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)ò,me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò Kapitulli IV ñLlogaritë e të tretëve, klasa 4ò Seksioni I ñPërbërja, klasifikimi dhe sqarime të përgjithshmeò pika 2

Impakti:

Detyrimet për vendime gjyqësore si rezultat i humbjeve të proceseve gjyqësore nga Bashkia Pustec, kanë sjellë rritjen e detyrimeve ndaj të tretëve si dhe pozicionimi gabim i këtyre detyrimeve ka sjellë paqartësi në klasifikimin e detyrimeve kreditore dhe vlerave të tyre me ndikim në realitetin e informacionit kontabël që ofrojnë PF për përdoruesit e interesuar të këtyre PF-ve.

Shkaku: Nga Sektori i Financës nuk janë kontabilizuar saktë në llogarinë përkatëse të klasës 4 detyrimet e konstatuara për investime

Rëndësia:E mesëm.

Rekomandimi:

Sektori i financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet që detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore të formës së prerë të pashlyera dhe kontratat e investimeve në vlerën **435,624 leke** të pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 **"**Kreditorë të ndryshëmò të pasivit të bilancit.

Në analizë: Në formatin nr. 2 "Pasqyra e përformancës financiare" paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF për vitin 2020 sipas zërave si vijon:

Llogaritë financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2020 (grant) në shumën **68,885,439** lekë. Të ardhurat e realizuara nga kjo Njësi vendore në vlerën 3,616,195 lekë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Korçë. Përfshirja në ketë format të PF e gjendjes të të ardhurave sipas llogarive analitike është bërë nga jashtë sipas ditarit të azhornuar nga drejtoria e taksave e tarifave vendore. Gjendja e secilës llogari te të ardhurave rakordon me vlerat e paraqitura në llogarite analitike të aktit të rakordimit me degën e thesarit Korçë.

Po kështu shumat e paraqitura në gjendjet e llogarive të shpenzimeve sipas natyrës të këtij formati rakordojnë me shumat e rezultuara në llogaritë e shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor në aktrakordimin e me degën e thesarit.
Pesha specifike e këtyre shpenzimeve të pasqyruara në këtë format si: Shpenzimet në llog. (600) ñPaga, shpërblime e të tjera personeliò në vlerën 35,508,141 lekë; Shpenzimet në llog. (601) ñKontribute të sig. Shoqërore e shëndetësoreò në vlerën 5,995,583 lekë shpenzimet në llog. (602) ñMallra shërbime të tjeraò në vlerën 10,264,289 lekë të shpenzimeve; Shpenzimet në llog. (604) ñTransferime korrente te brendshmeò në vlerën 2,690,000 lekë , Shpenzimet në llog. (606) ñTransferta për buxhete familjare e individëò në vlerën 13,060,633 lekë.
Për vitin 2020 totali i te ardhurave ne vlere është 72,501,634 lek dhe totali shpenzimeve është 45,096,150 lek. Diferenca e tyre ne vlerën 27,405,484 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 ñRezultatin e ushtrimitò *(Më hollësisht formati nr. 2 i të ardhurave ” është e analizuar sipas aneksi nr.12, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit).*

Paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe sigurimet shoqërore (llog 601)

Për vitin 2018 numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 43,datë 25.12.2017. Miratuar në total numri 64 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 64 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.
Për vitin 2019 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 91 datë 19.12.2018. Miratuar në total numri 72 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 72 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.
Për vitin 2020 numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 104 datë 24.12.2020. Miratuar në total numri 77 në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 77 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve.
-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Pustec është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.
Sipas listë pagesave të muajve janar 2018, shtator 2019 dhe nëntor 2020 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.
Listë pagesat janë të firmosura nga Përgjegjësi i Financës z. C. N. nga Kryetari i Bashkisë Pustec
Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Përgjegjësi i Financës z. C. N. dhe nga Kryetari Bashkisë; z. P. K..
Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore **znj. S. M.** dhe nga Kryetari Bashkisë z. P. K..

***Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.**
Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:
Me arkë janë kryer transaksione financiare, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifat familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim e lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, arkëtim gjoba të policisë Bashkiake. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.
Për vitin 2018, janë prerë Mandat Arkëtime në, vlerë 1,994,785 lekë dhe mbyllet me MA, në vlerë 1,994,785 lekë.

Për vitin 2019, janë prerë Mandat Arkëtime në, vlerë 1,133,215 lekë dhe mbyllet me MA, në vlerë 1,133,215 lekë.
Për vitin 2020, janë prerë Mandat Arkëtime në, vlerë 1,929,997 lekë dhe mbyllet me MA, në vlerë 1,929,997 lekë.
Nga auditimi i librit të arkës dhe ditarit të arkës konstatohet se të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitet, 2018-2020 janë derdhur totalisht në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të çdo viti është me zero lekë. Të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në Bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje zero në fund të muajit. Gjithashtu është mbajtur ditari i arkës në formën klasike kontabël i cili rezulton i kuadruar. Përfshirja e shumës të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò, si dhe të UMF nr.30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò pikat 63,64. Nga sektori i Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit për të ardhurat.

MALLRA DHE SHËRBIME (llogaria 602)
Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë
Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.
Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.
Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël. *Më hollësisht pagesat sipas llogarisë 602 paraqiten në aneksin nr.13, pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit).*

9.- Titulli gjetjes: Mungesa e sektorit të menaxhimit të aseteve si dhe e regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Pustec

Situata:
Për vitin 2018 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 43,datë 25.12.2017, për vitin 2019 struktura organizative është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 91 datë 19.12.2018 dhe për vitin 2020 struktura organizative është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 104 datë 24.12.2020, referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë

08.03.2017, struktura e Bashkisë Pustec është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Rezulton se në strukturën aktuale organizative të bashkisë Pustec nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve. *Sipas Urdhrit të Kryetarit të bashkisë nr. 166 datë 31.10.2019 është ngritur grupi i punës për përcaktimin e objekteve prioritare të bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksioninterritorial të bashkisë Pustecdhe me Udhërin nr. 149 prot, datë 27.09.2021 është bërë zëvendësimi i njëanëtari të larguar* **.** *Deri në momentin e mbajtjes së akt konstatimit grupi i punës nuk ka përfunduar punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.)* dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave tëtransferimit në NJQV, vënien në eficencë të ndërtesave dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive me sipërfaqe gjithsej 706 ha, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III ñRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreò, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 ñPër pronat e paluajtshme të shtetitò, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetëroreò, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreò, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendoreò, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 ñPër mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publikeò

Bashkisë Pustec, me VKM Nr 103 datë 3.2.2008 ñPër miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Liqenas të qarkut Korçëò, i është miratuar lista inventarit të pronave me 29 fletë dhe përfundon me numër rendor 148. Numri rendorë 1-10, prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, 11-20 prona që përfaqësojnë terrene sportive, vatër kulture dhe lapidare, 21-29 prona që përfaqësojnë troje pra infrastrukturë vendore, 30-38 shërbim funeral, 81-97 prona që përfaqësojnë infrastrukturë rrugore, 98-122 prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive), 123-137 prona që përdoren në fushën e mbrojtjes dhe 138-148 prona që janë të fushës së shëndetësisë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 69, datë 19.09.2018, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Pustec. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 148 (njëqind e dyzet e tetë) vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Korçë dhe me shkresë nr. **571**, datë **08.11.2018** është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme , Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

Me VKB nr. 98, datë 15.11.2019, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Bashkisë Pustec. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 121 (njëqind e njëzet e një)

Për pronat si më sipër nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve, nuk ka bërë regjistrimin e tyre në ZVRPP, nuk janë inventarizuar, nuk disponohej informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave sa nga këto prona janë të zëna sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

Për këto prona nuk janë lidhur kontrata qiraje në referencë të VKM nr. 529, datë 08.06.2011, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2017 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të

mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisështetërore në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, **toka të pafrytshme me sipërfaqe gjithsej 706 ha.**
Veprimet e më sipërmet, janë në kundërshtim me nenin 18, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 ñPër transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendoreò, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisështetëroreò, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreò.
Kriteri:
Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

-Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 ñPër transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendoreò, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisështetëroreò, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreò. Ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, ñPër Pyjet dhe Shërbimin Pyjorò, të ndryshuar,
Ndikimi/Efekti:
Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar
Shkaku:
Mungesa e sektorit të menaxhimit të aseteve si dhe e regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Pustec
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi:
- Bashkia Pustec, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Pustec dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore etj, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, i ndryshuar, me qëllim krijimin e të ardhurave

Auditimi mbi inventarizimin e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale; Jo materiale dhe Qarkulluese, sipas klasifikimit të tyre e mbajtjes së kartelave, raportimi i shtesave, apo përmirësimeve të kryera për gjatë periudhës raportuese në aktivin e duhur, për periudhën ushtrimore raportuese 2018-2020.
Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër

kontabilitetin e pasqyrat financiareò, pika (1), neni (7) ñInventari aktiveve e detyrimeveò; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kreu (IV) ñSistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveveò pika (81) dhe UMF nr. 28, datë 15.12.2011 ñMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit te kontrollit te brendshëm në njësite publikeò, në njësinë publike vendore Bashkia Pustec u auditua procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë të administruara në llogaritë; ñ*aktive afatshkurtër*ò; ñg*jendje inventar qarkullues*ò; ñ*materiale*ò; ñ*inventar i imët*ò; ñ*Aktive afatgjata jo materiale*ò dhe ñ*Aktive afatgjata materiale*ò.
Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhat raportuese objekt auditimi (*2018-2020*), u konstatua se, për realizimin e procesit të inventarizimit fizik të ñ*aktiveve afatgjata dhe afatshkurtër*ò (*materiale e jo materiale*) dhe ñ*inventar qarkullues*ò të pasurisë, Aseteve dhe vlerave materiale në përdorim të njësisë publike vendore Bashkia Pustec për periudhën raportuese ushtrimore 2018, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 9 date 04.02.2019 ñ*Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Pustec*ò me përbërje; znj. N. A. në cilësinë e kryetares, znj. S. V. në cilësinë e anëtarit, z P. A. në cilësinë e anëtarit. Znj M. S. në cilësinë e anëtarit dhe znj. Z. T. në cilësinë e anëtarit. Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur vetëm një relacion për fletë inventarët me gjendje fizike e kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik për llogarinë 32 ñInventari i Imëtò në vlerë 5,102,948 lekë.
Për vitin ushtrimor 2019 Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 124, datë 30.09.2019 ñ*Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Pustec*ò me përbërje të komisionit të inventarizimit janë; z. C. N. kryetar, z. I. M. anëtar, z V. A. anëtar, dhe z. Q. T. anëtar. Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur vetëm një relacion për fletë inventarët me gjendje fizike e kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik për llogarinë 32 ñInventari i Imëtò në vlerë 5,676,190 lekë.
Për vitin ushtrimor 2020 Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 226, datë 31.12.2020 ñ*Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Pustec*ò me përbërje të komisionit të inventarizimit janë; znj. P. P. kryetar, znj. P. D. anëtar, znj.P. T. anëtar, dhe znj D. S. anëtar. Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur vetëm një relacion për fletë inventarët me gjendje fizike e kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik për llogarinë 32 ñInventari i Imëtò në vlerë 10,417,958 lekë.

10. Titulli i Gjetjes: Nuk janë marrë masat e nevojshme për mirë administrimin e të gjitha Aktiveve afatgjatë materiale dhe jo materiale. Konkretisht për llogaritë e Aktiveve me vlerat neto sipas të dhënave të Pasqyrave Financiare të vitit 2019-2020:

Situata:
1- Në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, anëtaret e komisionit të inventarizimit në asnjë rast nuk kanë përpiluar deklarata për konflikt të interesit me punonjësit me përgjegjësi materiale, ose qe kanë në përdorim aktive dhe në rastet kur anëtar komisioni inventarizimi është përfshirë drejtuesi i njësisë që inventarizohet njëkohësisht edhe përgjegjës material.

2-Komisioni inventarizimit në fillim të procesit të inventarizimit, nuk ka në dispozicion listën e aktiveve për tôu inventarizuar e hartuar nga nëpunësi zbatues mbi bazën e të dhënave të pasqyruara nga regjistrat kontabël për secilën llogari kontabile të njësisë publike vendore.
3-Komisioni inventarizimit fizik në fillim të procesit, në asnjë rast nuk ka hartuar akt rakordimi për të përcaktuar e fiksuar numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes së fundit e kontabilizuar.
4-Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik të aktiveve, komisioni megjithëse nuk ka përpiluar përmbledhëse bashkëlidhur së cilës janë fletë inventarët me gjendjen fizike të aktiveve sipas llogarive me analizë në objektet e inventarizuara gjendje në datë 31.12.2018 deri në 31.12.2020 në përfundim nga auditimi u konstatua se;
5-në asnjë çast komisioni inventarizimit fizik nuk ka nxjerr rezultat me diferenca që kanë rezultuar në procesin e inventarizimit fizik për vlerat e aktiveve, aseteve, pasurisë dhe vlerave materiale, megjithëse në objektin e inventarizuar Bashkia Pustec. Inventarizimi fizik është kryer vetëm për llogarinë 32 ñInventari i Imëtò
Nga Bashkia Pustec, ***nuk janë kryer procedurat për inventarizimin*** e të gjitha aktiveve afat gjata jo materiale dhe materiale të investuara në vite nga Bashka Pustec dhe ato që me miratim të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të kësaj bashkie, konkretisht për llogaritë (me kostot historike):
Llogaria 202 ñStudime dhe kërkimeò për vlerën 18,399,892 lekë
Llogaria 211 ñ*Pyje kullota plantacione"* për 1,793,836 lekë.
Llogaria 212 ñ*Ndërtime konstruksione*òpër 50,082,499 lekë.
Llogaria 213 ñ*Rrugë rrjete vepra ujore*ò për 123,401,363 lekë.
Llogaria 214 ñInstalime teknike,makineri, pajisje,vegla puneò për vlerën 8,527,462 lekë
Llogaria 215 *"Mjete transporti*ò për 36,425,797 lekë.
Llogaria 218 ñInventar ekonomikòpër vlerën 5,241,702 lekë
-Nuk është përgatitur regjistri i pronave.
-Nuk është bërë regjistrimi i aktiveve në pronësi të Bashkisë.
Për veprime dhe mosveprime ngarkohet me përgjegjësi:
1- z. C. N., në cilësinë e Përgjegjësit të Financës, për periudhën 2018-2020
2. znj. E. A. në cilësinë e personit përgjegjës për ndjekjen e kontratave, për periudhën 2018-2020
Kriteri:
Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

-ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë; Kap. VII, neni 23, pika 14 –Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj , UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme". Kap III
Impakti:
Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë të llogarive, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.
Shkaku:
Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve.
Rëndësia:- E Lartë.

Rekomandimi:
Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet të kaluara me VKM-të përkatëse, si dhe për krijimin e regjistrit të pronave.

3. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017, "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël".

a. *Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.*
b. *Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.*
c. *Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).*
d. *Auditim mbi zbatimin e kushteve në kontratave të lidhura me operatorë ekonomik të shpallur fitues për mallra dhe shërbime, si dhe marrja në dorëzim e tyre sipas specifikimeve teknike.*
e. *Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomike fitues.*

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
Nga auditimi ka rezultuar se, është hartuar regjistri i parashikimeve për vitet 2018, 2019 dhe 2020 si dhe regjistri i realizimit të prokurimeve për këto vite.
Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Pustec". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pakësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB ï ve përkatëse.
NJP dhe NZ, kanë vepruar në përputhje me VKM, nenin 4 ñRegjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publikò, pika 1.
Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 914, neni 4, pika 3.
Nga auditimi ka rezultuar se gjatë periudhës së auditimit ka patur ndryshim të regjistrit të parashikimeve. Të gjitha ndryshimet janë hedhur në SPE, referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshime, neni 4, pika 4.

Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.
Për kryerjen e auditimit mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit për investime publike për periudhën objekt auditimi, nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:
- Programi buxhetor Afatmesëm 2018-2020-2022; Plani i Buxhetit; Fakti i buxhetit; Regjistri i Parashikimeve si dhe Regjistri i Realizimeve.

Në regjistrin e parashikimit të prokurimit publik (me vlera të vogla dhe të larta), për vitin 2018 janë programuar fonde buxhetore në vlerën 16,857,619 lekë, por realizimi i këtij regjistri është në vlerën 9,333,332 lekë, ose në masën 55%.

Për vitin 2019 janë programuar fonde buxhetore në vlerën 41,119,813 lekë, por realizimi i këtij regjistri është në vlerën30,326,182 lekë, ose në masën 73%.
Për vitin 2020 janë programuar fonde buxhetore në vlerën 27,462,519 lekë, por realizimi i këtij regjistri është në vlerën 8,689,451 lekë, ose në masën 32%.
Diferencat e dukshme midis planifikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, tregojnë programime jo reale, jashtë mundësive për tâu mbuluar me fonde buxhetore, fryrje artificiale të shpenzimeve.

Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).
Për auditimin e kësaj nën çështjeje u verifikuan: Dosjet e procedurave; Përcaktimi i kritereve të vlerësimit; Hartimi i DT;
Administrimi i dosjeve të prokurimit: Urdhrat e Titullarit të AK; Procesverbalet e mbajtura nga NJP dhe KVO, etj; Raporti përfundimtar; Korrespondenca me OE; Dokumentacioni që plotësohet nga AK; Korrespondenca me APP dhe KPP; Dokumentacioni mbi angazhimin e fondeve buxhetore.
Mbi administrimin e dosjeve nga NJP: Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e prokurimit për të gjitha procedurat e audituara, nga ku rezultoi se: Në përgjithësi nga NJP, janë zbatuar të gjitha detyrat e përcaktuara, si: përgatitja e regjistrave të prokurimit; përzgjedhja e llojit të procedurës, hartimi Urdhrit të prokurimit; përgatitja e DT, plotësimi i gjithë dokumenteve standarde për tâu plotësuar nga AK, ka administruar të gjitha procesverbalet e mbajtura gjatë zhvillimit të procedurës; ka respektuar afatet e procedurës, ka administruar dokumentacionin e OE fitues, ka shqyrtuar dhe ka reflektuar të gjitha Rekomandimet e APP-së, mbi kriteret kualifikuese, sipas vërejtjeve të saj gjatë monitorimit të procedurave, etj. Nga ana e Juristit të NJP janë administruar dhe inventarizuar të gjitha dosjet e prokurimit. Pjesë e dosjeve ishte i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas akteve ligjore, nënligjore dhe DST.
Sa më sipër, juristi i NJP ka vepruar në përputhje me VKM nenin 57, ñPersoni përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimitò, pika 3.

- **Mbi auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit publik:**

Në Bashkinë Pustec për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 8 procedura prokurimi me fond limit 39,831 mijë lekë, nga të cilat janë audituar 3 prej tyre me fond limit 32,331 mijë lekë ose 81.17% e fondit limit dhe 40.% e numrit të prokurimeve të zhvilluara, sa më poshtë vijon
në lekë

vitet	**zhvilluar**		**audituar**		**në % kundrejt:**	
procedura	**nr.**	**fond limit**	**nr.**	**fond limit**	**nr.**	**vlerë**
2018	**3**	**9,333,332**	**1**	**5,916,666**	**33**	**63**
• kërkesë për propozim	3	9,333,332	1	5,916,666	**33**	**63**
2019	**4**	**26,664,897**	**1**	**22,581,165**	**25**	**85**
• të hapur	1	22,581,165	1	22,581,165	**100**	**100**
• kërkesë për propozim	3	4,083,732				
2020	**1**	**3,833,333**	**1**	**3,833,333**	**100**	**100**
Kërkesë për propozim	1	3,833,333	1	3,833,333	**100**	**100**
Totali	**8**					

2018-2020	zhvilluar		audituar		në % kundrejt fondit limit:
Lloji i procedurës	**nr.**	**fond limit**	**nr.**	**fond limit**	
○ kërkesë për propozim	7	17,250,397	2	9,749,999	56%
○ të hapura	1	22,581,165	1	22,581,165	100%
Total	**8**	**39,831,562**	**3**	**32,331,164**	**81%**

Burimi i të dhënave: Bashkia Pustec.

Rezulton se procedura më e përdorur si numër është ajo ñkërkesë për propozimò e cila zë 43 % të fondeve të prokuruara.

Sipas riskut dhe materialitetit bazuar në llojin e procedurave për vitet objekt auditimi mbulimi me auditimin i procedurave të prokurimit është në masën 81%. e fondit limit.

Viti 2018.

Në vitin 2018, janë realizuar 3 procedura prokurimi, të cilat janë procedurë ñkërkesë për propozimò. Fondi limit për 3 procedurat e prokurimit të vitit 2018 është 9,333,332 lekë pa tvsh. Për vitin 2018 është audituar 1 procedurë prokurimi me vlerë të fondit limit në shumën prej 5,916,666 lekë pa tvsh, konkretisht sipas tabelës nr.1, sa më poshtë vijon:

Tabela nr. 1, "Mbi procedurat e prokurimit dhe të audituara nga të zhvilluarat në Bashkinë Pustec, për periudhën viti 2018".

Nr	Objekti	Fondi limit	Procedura	OE fitues	Vlera e ofertës fituese	Diferenca nga fondi limit	Operatorë ekonomikë		
							Total	S`kualifikuar	Kualifikuar
	Viti 2018								
1	Sistemim asfaltim rruge fshati Dollna Gorica	5,916,666	K. propozim	A. II.	**3,982,433**	1,934,135	7	1	6
	Totali	**5,916,666**			**3,982,433**	**1,934,135**	**7**	**1**	**6**

Viti 2019.

Në vitin 2019, janë realizuar 4 procedura prokurimi, nga të cilat 3 janë procedurë ñkërkesë për propozimò dhe 1 është procedure ñe hapurò. Fondi limit për 4 procedurat e prokurimit të vitit 2019 është 26,664,897 lekë pa tvsh. Për vitin 2019 është audituar 1 procedurë prokurimi me vlerë të fondit limit në shumën prej 22,581,165 lekë pa tvsh, konkretisht sipas tabelës nr.1, sa më poshtë vijon:

Tabela nr. 1, "Mbi procedurat e prokurimit dhe të audituara nga të zhvilluarat në Bashkinë Pustec, për periudhën viti 2019".

Nr	Objekti	Fondi limit	Procedura	OE fitues	Vlera e ofertës fituese	Diferenca nga fondi limit	Operatorë ekonomikë

							Total	S`kualifikuar	Kualifikuar
	Viti 2019								
1	Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Pustec	22,581,165	E hapur	B.B. &P. V.	18,737,420	3,843,745	8	3	5
	Totali	**22,581,165**			**18,737,420**	**3,843,745**	**8**	**3**	**5**

Viti 2020.

Në vitin 2020, është realizuar 1 procedurë prokurimi, e cila është procedurë ñkërkesë për propozimò. Fondi limit për këtë procedure prokurimi të vitit 2020 është 3,833,333 lekë pa tvsh. Për vitin 2020 është audituar kjo procedurë prokurimi me vlerë të fondit limit në shumën prej 3,833,333 lekë pa tvsh, konkretisht sipas tabelës nr.1, sa më poshtë vijon:

Tabela nr. 1, "Mbi procedurat e prokurimit dhe të audituara nga të zhvilluarat në Bashkinë Pustec, për periudhën viti 2020".

Nr	Objekti	Fondi limit	Procedura	OE fitues	Vlera e ofertës fituese	Diferenca nga fondi limit	Operatorë ekonomikë		
							Total	S`kualifikuar	Kualifikuar
	Viti 2020								
1	Sistemim terreni sportive pranë shkollës së mesme të bashkuar Pustec	3,833,333	K. propozim	B.B.	2,636,456	1,196,877	6	2	4
	Totali	**3,833,333**			**2,636,456**	**1,196,877**			

Në mënyrë analitike sipas procedurave të audituara ka rezultuar:

ZhvillimiiProcedurëssëProkurimitmeobjekt: Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar Pustec.		
1. UrdhërProkurimi: **nr. 412** prot. datë 13.05.2019	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** nr. 412 datë 13.05.2019	**4. Komisioni i V. Ofertave:** nr. 412/1, datë 13.05.2019
2.LlojiiProcedurëssëProkurimit ñE hapurò	N. K. ï Sp. prokurimi N. A. ï Ekonomiste A. T. - Ekonomist	C. N. ï Kryetar I. M. ï Anëtar V. A. ï Anëtar
5. FondiLimit(patvsh) 22,581,165 lekë	**6. Ofertafituese(patvsh):** 18,737,420lekë (B.B. &P. V.)	**7. Diferencamefondinlimit:** **(patvsh)** 3,843,745 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: **02.07.2019**	**9. BurimiFinancimit** Buxheti i shtetit	**10. Operatorët Ekonomikë:** **a)** Pjesëmarrës në tender, 8 OE **b)** Kualifikuar 5 OE **c)** Sôkualifikuar 3 OE

11. Ankimime AK – shkresa nr.488 prot., datë 05.06.2019; shkresa nr.646 prot., datë 22.07.2019; shkresa nr.647 prot., datë 22.07.2019; shkresa nr.656 prot., datë 23.07.2019.	**12.PërgjigjeAnkesës** nga AK ï shkresa nr.488/1 prot., datë 06.06.2019; shkresa nr.646/1 prot., datë 05.07.2019; shkresa nr.647/1 prot., datë 05.07.2019; shkresa nr.656/1 prot., datë 05.07.2019.	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP ï sôka

1. Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt ñRikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Pustecò, me fond limit **22,581,165lekë pa tvsh**.

Situata: Përsa i përket kritereve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezulton se kriteret për kualifikim nuk janë argumentuar dhe nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, si: kërkesa për paraqitjen e aktit të marrjes në dorëzim të punimeve, numri i punonjësve, makineritë, certifikatat ISO, kërkesa për mjek, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenin 61, ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP, të përbërë nga z. N. K., znj. N. A. dhe z. A. T..

Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 8 OE, janë sôkualifikuar 3 prej tyre dhe janë kualifikuar 5 OE.

Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e BOE të shpallur fitues ñB.B.ò shpk & ñP. V.ò shpk, me vlerë të ofertës në shumën prej 18,737,420 lekë pa tvsh, janë si më poshtë:

Për plotësimin e kriterit për punë të ngjashme, OE ñB.B.ò shpk, ndër të tjera ka paraqitur edhe 2 kontrata për punë të ngjashme dhe më konkretisht si vijon:

- Kontratën e lidhur me Bashkinë Memaliaj, me objekt ñRikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Nimete Proganati, Memaliajò me nr. sôka prot., datë 15.08.2016. Vlera e kontratës është 19,706,870 lekë me TVSH.
- Kontratën e lidhur me Bashkinë Mallakastër, me objekt ñNdërtim shkolle 9 vjeçare 2KT + kalçeto dhe kënd sportive, në fshatin Panahor-Mallakastërò, me nr. 1802 prot., datë 06.10.2016. Vlera e kontratës është 59,377,004 lekë me TVSH.

OE ñB.B.ò shpk, nuk ka pasqyruar në Ekstraktin e QKR-së edhe këto vende të zhvillimit të biznesit si dhe hapjen e niptit sekondar e për rrjedhojë nuk ka paraqitur as vërtetim për shlyerjen e taksave në këto 2 Bashki.

Operatori ndonëse zhvillon aktivitet biznesi në vendndodhje të ndryshme nga selia, nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e QKR-së, si vende zhvillimi të biznesit ku do te duhej të pajisej edhe me NIPT sekondar për këto vende te tjera zhvillimi biznesi, e më tej të paguante detyrimet vendore e të pajisej me vërtetim për secilin prej këtyre njësive. Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari ne adresa (vendndodhje) te ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka një NIPT ñunikò. Mosregjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPer procedurat tatimoreò nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit nr. 131/2015 ñPër qendrën kombëtare të biznesitò, si dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 ñPër Qendrën Kombëtare të Regjistrimitò.

Operatori ekonomik ñP. V.ò shpk ka paraqitur disa kontrata noteriale si më poshtë vijon:

1-Kontratë noteriale me nr. 1681 Rep., dhe 906 Kol., të datës 31.05.2019 të lidhur me z. Xh. F., me anë të së cilës ka marrë me qera 1 kamion me targa AA ... UE.

2-Kontratë noteriale me nr. 1304 Rep., dhe 457 Kol., të datës 14.06.2019 të lidhur me shoqërinë ñL.ò shpk, me anë të së cilës ka marrë me qera disa kamiona.

3-Kontratë noteriale me nr. 803 Rep., dhe 265 Kol., të datës 09.04.2019 të lidhur me shoqërinë ñE. M.ò shpk, me anë të së cilës ka marrë me qera 1 kamion me targa AA ... GS.

Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 ñ*Për transportet rrugore*ò, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, ñ*Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë*ò, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, ñ*Transporti i mallrave për vete*ò, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me liçencën përkatëse.
Në rastet konkrete, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se çertifikata e mjetit të mësipërm të cilën e disponon z. Xh. F. sipas lejes të qarkullimit, është ***specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së z. Xh. F., person fizik***.
Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë ñP. V.ò sh.p.k. me kamionin e z. Xh. F. do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa liçencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit ñ*Për transportet rrugore*ò është i ndaluar. E njëjta gjë edhe përsa i përket kamionave të marra me qera nga shoqëria ñL.ò shpk, pasi leja e qarkullimit të tyre është lëshuar vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion vetëm për llogari të shoqërisë ñL.ò shpk. Përsa i përket kamionit të marrë me qera nga shoqëria ñE. M.ò shpk, certifikata e kontrollit teknik të këtij mjeti ka skaduar në datën 09.06.2019, pra përpara datës së zhvillimit të kësaj procedure prokurimi dhe nuk është rinovuar.
Shpallja fitues e BOE ñB.B.ò shpk & ñP. V.ò shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 18,737,420 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. C. N., z. I. M. dhe z. V. A..
Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti: përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 18,737,420 lekë.
Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandim: Nga ana e bashkisë Pustec të merren masa për vendosjen e kritereve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1399 datë 29.10.2021, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 870/3 datë 04.11.2021 dhe me shkresën nr. 1648 datë 13.10.2021 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 870/5 prot., datë 20.12.2021 janë ripërsëritur observacionet e Akt Konstatimeve,nga punonjësit e subjektit të audituar të përmendur në këto procedura prokurimi si anëtarë të njësisë së prokurimit dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave, ku janë shprehur komentet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Në lidhje me kërkesën e përcaktuar nga njësia e prokurimit ñ*Akti i marrjes në dorëzim* ñ, ju informojmë se ky dokument është i nevojshëm për të përcaktuar se kontrata e paraqitur për punët e ngjashme është realizuar nga operatori ekonomik dhe nga ana e Autoriteti Kontraktor është marrë në dorëzim si objekt i përfunduar. Afati 1-2 vjet është për Çertifikatën përfundimtare të marrjes në dorëzim të objektit. pasi ka kaluar edhe garancia e punimeve.
Në lidhje me kërkesën Çertifikatë EN ISO 3834-2:2006 ñ*Për sistemin e menaxhimit të cilësisë të saldimit"*, ju informojmë se në preventivin e punimeve kemi të bëjmë me punime dhe material të cilat janë të ndërthurur me punimet e saldimit.

Në lidhje me kërkesën mbi numrin e punonjësve të kërkuar në këtë procedurë ju informojmë se pas rekomandimit të paraqitur nga Agjencia e Prokurimit Publik ky kriter është rishikuar nga AK duke e ulur dhe duke kërkuar punonjësit të cilët janë të nevojshëm për realizimin e këtij objekti.
Lidhur me sugjerimet e rekomanduara nga APP për ndryshimin e kritereve NJHDST i ka marrë në konsideratë dhe ka bërë ndryshimet të cilat faktohen nga shtojca Nr.1 e datë 18.06.2019 me nr. 537 Prot ku pasqyrohen ndryshimet si kanë qenë dhe si janë bërë. po ju vëmë në dispozicion shtojcën.
Përsa i përket licencës N.P.3-B ñ*Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash*ò NJHDST-ja e ka vendosur këtë licencë në arsyetimin se fondi prej 22,581,165 lek është pjesë e fushës së përcaktuar në këtë licencë ku përcaktohet nga 21-50 milion.
Ju informojmë se në këtë procedurë prokurimi është krijuar konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomik pasi kanë marrë pjesë 8 operatore.
Në lidhje me BOE óB. B.ñ dhe ñP. V.ò ju informojmë se Komisioni i vlerësimit ka vlerësuar ofertën ekonomikisht më të favorshme duke kualifikuar BOE i cili i plotëson kriteret sipas atyre të përcaktuar në DST. Nga KVO është mbajtur parasysh kualifikimi i operatorit ekonomik me vlerë me të ulët dhe që plotëson kriteret.
Për sa i përket paraqitjes se vërtetimit mbi pagesën e taksave lokale ju informojmë se Komisioni i vlerësimit të Ofertave i është referuar adresave të përcaktuara në ekstraktin e QKR ku operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet.
Në lidhje me kontratën noteriale nr.1681 Rep, Nr.906 Kol datë 31.05.2019 me Xh. F. për marrjen me qira të kamionit me targë AA ... UE, ju informojmë se operatori ekonomik ka një kontratë noteriale të lidhur dhe në lidhje me çertifikatën e mjetit për transportin e mallrave nga ana e KVO bazuar në VKM Nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin rregullave të prokurimit Publikò shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave është marrë si **devijim i vogël** për të mos shkaktuar dëm ekonomik.
Për sa i përket kamionçinës me targë AA ... GG ju informojmë se KVO për të verifikuar këtë mjet është referuar lejes së qarkullimit e cila është në pronësi të Operatorit Ekonomik ñP. V.ò.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Për sa i përket kamionçinës me targë AA ... GG, pretendimi juaj merret parasysh.
Përsa i përket kërkesës **për paraqitjen e aktit të marrjes në dorëzim**, nuk keni sqaruar nëse është fjala për aktin e marrjes së përkohshme në dorëzim apo atë përfundimtar, pasi nëse do të ishte kërkuar akti përfundimtar i marrjes në dorëzim, kjo është kërkesë **e tejkaluar e** VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nenin 26 ñKontratat për punë publikeò të VKM nr.914 dt.29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 ï 2 vjeçare, duke tejkaluar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Ky pretendim nuk merret parasysh.
Përsa i përket numrit të punonjësve të vendosur, pavarësisht emailit zyrtar të APP dhe shtojcës së bërë nga ana juaj, përsëri vendosja e numrit të punonjësve nuk është bërë e bazuar në manual dhe e përllogaritur se përse janë të nevojshëm 55 punonjës për realizimin e kësaj kontrate. Ky pretendim nuk merret parasysh.
E njëjta gjë edhe përsa i përket licencës N.P.3-B ñ*Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash*ò pasi i gjithë fondi limit është në shumën prej 22,581,165 lekë dhe nuk është vetëm për këtë lloj punimesh në këtë shumë sipas preventivit.
Në lidhje me taksat lokale, ky operator ekonomik ka marrë punë të cilat nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e tij të QKR.

Përsa i përket kamionit të marrë me qera, ai është në kundërshtim me ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 ñ*Për transportet rrugore*ò, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, ñ*Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë*ò, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, ñ*Transporti i mallrave për vete*ò, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me licencën përkatëse dhe nuk mund të klasifikohet si devijim i vogël.
Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj, përveç argumentimit mbi mjetin, komentet e tjera nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

ZhvillimiiProcedurëssëProkurimitmeobjekt: Sistemim asfaltim Rruga fshati Dolna Gorica (Faza 1).		
1. UrdhërProkurimi: **nr. 423** prot. datë 26.07.2018 **2.LlojiiProcedurëssëProkurimit** ñKërkesë për propozimò	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** nr. 423 datë 26.07.2018 N. K. ï Sp. prokurimeve S. M. ï Juriste N. A. ï Ekonomiste	**4. Komisioni i V. Ofertave:** nr. 424, datë 26.07.2018 I. M. ï Kryetar V. A. ï Anëtar A. C. ï Anëtar
5. FondiLimit(patvsh) 5,916,568 lekë	**6. Ofertafituese(patvsh):** **3,982,433** lekë (A. II. shpk)	**7. Diferencamefondinlimit:** **(patvsh)** 1,934,135 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: **22.08.2018**	**9. BurimiFinancimit** Buxheti i bashkisë + grand	**10. Operatorët Ekonomikë:** **a)** Pjesëmarrës në tender, 7 OE **b)** Kualifikuar 6 OE **c)** Sëkualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK – shkresa nr.427/3 prot., datë 14.09.2018	**12.PërgjigjeAnkesës** nga AK ï shkresa nr.523 prot., datë 18.09.2018	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP - Vendimi nr.776 prot., datë 15.11.2018

2. Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt ñSistemim asfaltim rruga fshati Dollna Gorica (Faza 1)ò, me fond limit **5,916,666lekë pa tvsh**.

Situata: Përsa i përket kritereve të veçanta të vendosura në DST nga njësia e prokurimit rezulton se kriteret për kualifikim nuk janë argumentuar dhe nuk ishin në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, si: kërkesa për paraqitjen e aktit të marrjes në dorëzim të punimeve, numri i punonjësve, makineritë, certifikatat ISO, etj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, nenin 61, ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP, të përbërë nga z. N. K., znj. S. M. dhe znj. N. A.. Nga auditimi rezultoi se kanë marrë pjesë 7 OE, është sëkualifikuar 1 prej tyre dhe janë kualifikuar 6 OE.
Për plotësimin e kriterit 2.3.1 përsa i përket punëve të ngjashme, ky operator ka paraqitur këto kontrata si vijon:
- Kontratën e lidhur me Bashkinë Maliq, me objekt ñSistemim asfaltim rruge të brendshme fshati Maliq, Bashkia Maliqò me nr. 1045 prot., datë 10.03.2016. Vlera e kontratës është 35,979,114 lekë me TVSH.
- Kontratën e lidhur me Bashkinë Maliq, me objekt ñRikonstruksion, sistemim-asfaltim i rrugës Petrushë - Vreshtasò me nr. 5997 prot., datë 09.12.2016. Vlera e kontratës është 105,600,000 lekë me TVSH. Në këtë procedurë ka marrë pjesë si bashkim operatorësh.

OE ñA. II.ò shpk, nuk ka pasqyruar në Ekstraktin e QKR-së edhe këto vende të zhvillimit të biznesit si dhe hapjen e niptit sekondar e për rrjedhojë nuk ka paraqitur as vërtetim për shlyerjen e taksave në Bashkinë Maliq.
Operatori ndonëse zhvillon aktivitet biznesi në vendndodhje të ndryshme nga selia, nuk i ka pasqyruar në ekstraktin e QKR-së, si vende zhvillimi të biznesit ku do te duhej të pajisej edhe me NIPT sekondar për këto vende te tjera zhvillimi biznesi, e më tej të paguante detyrimet vendore e të pajisej me vërtetim për secilin prej këtyre njësive. Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari ne adresa (vendndodhje) te ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka një NIPT ñunikò. Mosregjistrimi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 ñPer procedurat tatimoreò nenin 40, nenin 3.1/a.b.c te ligjit nr. 131/2015 ñPër qendrën kombëtare të biznesitò, si dhe ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 ñPër Qendrën Kombëtare të Regjistrimitò.
Operatori ekonomik ñA. II.ò shpk ka paraqitur një kontratë noteriale për marrje kamioni me qera si më poshtë vijon:
1-Kontratë noteriale me nr. 1239 Rep., dhe 718/1 Kol., të datës 29.06.2018 të lidhur me z. F. M., me anë të së cilës ka marrë me qera 1 kamion me targa AA ... PT.
Në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 ñ*Për transportet rrugore*ò, neni 1, 3, 5 dhe Kreut III.1, ñ*Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë*ò, nenet 41, 42, 43 dhe 44, si dhe Kreut III.2, ñ*Transporti i mallrave për vete*ò, nenet 45, 46, dhe 47, bëhet qartësisht ndarja midis këtyre mënyrave të transportit dhe përcaktohet ndalimi i secilës nga mënyrat e transportit pa pajisjen me liçencën përkatëse. Në rastin konkret, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se çertifikata e mjetit të mësipërm të cilën e disponon z. F. M. sipas lejes të qarkullimit, është ***specifike dhe e lëshuar vetëm për transport për vete, për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së z. F. M., person fizik***.
Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e shoqërisë ñA. II.ò sh.p.k. me kamionin e z. F. M. do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa liçencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit ñ*Për transportet rrugore*ò është i ndaluar.
Në shtojcën nr.9 mbi disponimin e makinerive, operatori ekonomik ñA. II.ò shpk, ka deklaruar këto mjete në pronësi: Shtojca 9

Ndërkohë që në inventarin e bilancit të vitit 2017 të paraqitur nga ky operator, figurojnë këto mjete si më poshtë vijon:

Nga verifikimi i deklaratës së bërë nga ky operator në shtojcën 9, krahasuar me mjetet e inventarit si më sipër, rezulton se makineritë e mëposhtme me këto targa, nuk figurojnë në inventarin e bilancit të vitit 2017.
DV .... A;
DV .... A;
AA ... UF;
AA ... UF.
Sa më sipër KVO nuk e ka konstatuar faktin se ky OE ka paraqitur deklarim të rremë në këtë procedurë prokurimi. Mosveprimi i KVO-së për paraqitjen e deklarimit të rremë, nga ana e OE ñA. II.ò shpk, është në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ñ*Për prokurimin publik*ò, i ndryshuar, neni 47, ñ*S'kualifikimi i ofertuesve*ò, dhe neni 13, pika 3.

Shpallja fitues e OE ñA. II.ò shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar **përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 3,982,433 lekë** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. I. M., z. V. A. dhe z. A. C..
Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.
Ndikimi/Efekti: përdorim të paligjshëm të fondeve publike në vlerën 3,982,433 lekë.
Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandim: Nga ana e bashkisë Pustec të merren masa për vendosjen e kritereve të DST në përputhje me objektin e prokurimit si dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të OE që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DST.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1399 datë 29.10.2021, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 870/3 datë 04.11.2021 dhe me shkresën nr. 1648 datë 13.10.2021 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 870/5 prot., datë 20.12.2021 janë ripërsëritur observacionet e Akt Konstatimeve, nga punonjësit e subjektit të audituar të përmendur në këto procedura prokurimi si anëtarë të njësisë së prokurimit dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave, ku janë shprehur komentet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Në lidhje me kërkesën e përcaktuar nga njësia e prokurimit ñ*Akti i marrjes në dorëzim* ñ, ju informojmë se ky dokument është i nevojshëm për të përcaktuar se kontrata e paraqitur për punët e ngjashme është realizuar nga operatori ekonomik dhe nga ana e Autoriteti Kontraktor është marrë në dorëzim si objekt i përfunduar. Afati 1-2 vjet është për Çertifikatën përfundimtare të marrjes në dorëzim të objektit. pasi ka kaluar edhe garancia e punimeve.
Në lidhje me numrin e të punësuarve që duhet të disponojë operatori ekonomik ju informojmë se ky është një numër minimal që është kërkuar për realizimin e këtij objekti dhe nga Agjencia e Prokurimit publik nuk është parë numër i ekzagjeruar dhe nuk është rekomanduar ndryshimi.
Në lidhje me mjetet e kërkuara ju informojmë se këto mjete janë të nevojshme për realizimin e punimeve pasi (*kamioni kërkohet për transport të materialeve inerte, Kamionçina për transportin e materialeve dhe veglave të punës, fadroma për lëvizjen e inerteve dhe sistemimin e terrenit të objektit, Asfaltoshtruse për hedhjen e asfaltit, Autobitumatriçe e nevojshme për shpërndarjen e materialit bitum, Ruli për ngjeshjen e materialit çakull si dhe për ngjeshjen e asfaltit, autobot uji për tu përdorur në kantier si dhe për lagien e trupit të rrugës për të realizuar ngjeshjen e materialit, greider për nivelimin e trupit të rrugës, motobetoniere për përgatitjen e betonit*), nga kjo shikojmë se numri i makinerive që është kërkuar është minimal dhe që shërbejnë për realizimin e objektit.
Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik që do të thotë se është realizuar konkurrenca e nevojshme për zhvillimin e saj.
Për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ñV.ò shpk ju informojmë se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët bërë nga ky operator nuk është marrë parasysh nga KVO pasi nuk është shoqëruar me dokument justifikues (*fatura tatimore të blerjes së mallrave*) për të vërtetuar çmimet e ulta të vendosura në ofertën e paraqitur. Për këtë operatori ekonomik ka ñV.ò shpk ka paraqitur ankesë pran AK ku nuk është marrë parasysh. Operatori ekonomik óV.ò shpk i është drejtuar dhe Komisionit të Prokurimit Publik ku me Vendimin nr 1520/1prot, datë 25.09.2018 ka vendosur të mos marrë parasysh ankesën e këtij operatori ekonomik dhe

njëkohësisht duke lënë në fuqi Vendimin e Komisionit të Vlerësimit sit ë drejtë dhe të bazuar në ligj.
Ju bëjmë e dije se nga ana e Bashkisë Pustec kemi një kursim të fondeve publike pasi operatori i shpallur fitues është shpallur me një vlerë shumë të ulët me një diferencë nga fondi limit 1,934,135 lekë.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Përsa i përket kërkesës **për paraqitjen e aktit të marrjes në dorëzim**, nuk keni sqaruar nëse është fjala për aktin e marrjes së përkohshme në dorëzim apo atë përfundimtar, pasi nëse do të ishte kërkuar akti përfundimtar i marrjes në dorëzim, kjo është kërkesë **e tejkaluar e** VKM nr. 914, datë 29.12.2014, nenin 26 ñKontratat për punë publikeò të VKM nr.914 dt.29.12.2014 ñPër Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, pasi akti i marrjes në dorëzim bëhet për një periudhë kohore 1 ï 2 vjeçare, duke tejkaluar në këtë mënyrë afatin tre vjeçar të periudhës së kërkuar. Ky pretendim nuk merret parasysh.
Përsa i përket numrit të punonjësve të vendosur, pavarësisht se nga APP nuk ka pasur ndërhyrje, përsëri vendosja e numrit të punonjësve nuk është bërë e bazuar në manual dhe e argumentuar. Ky pretendim nuk merret parasysh. E njëjta gjë edhe për mjetet e vendosura në DST.
Përsa i përket sõkualifikimit të OE ñV.ò shpk, ato qëndrojnë por nga ana tjetër ju nuk keni konstatuar mangësitë në dokumentacionin e OE të shpallur fitues.
Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj nuk janë të argumentuara si dhe nuk kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.

ZhvillimiiProcedurëssëProkurimitmeobjekt: Sistemim terreni sportive pranë shkollës së mesme të bashkuar Pustec.		
1. UrdhërProkurimi: **nr. 1124/1** prot. datë 12.10.2020 **2.LlojiiProcedurëssëProkurimit** ñKërkesë për propozimò	**3. Hartuesit e D. Tenderit:** nr. 1124/1 datë 12.10.2020 L. M.ï Jurist R. Q.ï Arkitekt V. S.ï Sp.prokurimi	**4. Komisioni i V. Ofertave:** nr. 1124/1, datë 12.10.2020 V. A. ï Kryetar P. D. ï Anëtar P. A.i ï Anëtar
5. FondiLimit(patvsh) 3,833,333 lekë	**6. Ofertafituese(patvsh):** **2,636,456** lekë (B.B.) shpk	**7. Diferencamefondinlimit:** **(patvsh)** 1,196,877 lekë
8. Data e hapjes së tenderit: **23.10.2020**	**9. BurimiFinancimit** Grand	**10. Operatorët Ekonomikë:** **a)** Pjesëmarrës në tender, 6 OE **b)** Kualifikuar 4 OE **c)** Sõkualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK – s'ka	**12.PërgjigjeAnkesës** nga AK ï	**13. Përgjigje** Ankesës nga KKP -

Nga auditimi i procedurës rezultoi se janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1399 datë 29.10.2021, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 870/3 datë 04.11.2021, nga punonjësit e subjektit të audituar të përmendur në këto procedura prokurimi si anëtarë të njësisë së prokurimit dhe të komisionit të vlerësimit të ofertave, ku janë shprehur komentet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:
Nga njësia e prokurimit ka filluar procedura e prokurimit me nxjerrjen e urdhrit të prokurimit. Njësia e prokurimit bazuar në VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të*

prokurimit Publik", ka hartuar me proçes verbalin ñ*Për hartimin e dokumenteve të tenderit*ò, të cilin po e vendosim në dispozicion, për kërkesat e përgjithshme janë lënë ato të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit.
Konkretisht nga ana e NJHDT është hartuar procesverbali me nr.1124/3 datë:12.10.2020 ku në pika 2 e në vijim janë bërë argumentimet e kritereve në saj të interpretimeve ligjore si dhe në zbërthim të preventivit. Bashkëngjitur ju vemë në dispozicion procesverbalin.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:
Ju sqarojmë se në lidhje me komentet e bëra nga ana juaj janë të argumentuara si dhe kanë mbështetje ligjore dhe për këtë arsye merren në konsideratë.

Blerjet me vlera të vogla

Në zbatim të programit të auditimit të sipërcituar, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:
Për vitin 2018 është krijuar Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nr.1/2 prot., datë 15.01.2018, me Urdhër nr.2, datë 15.01.2018 të Titullarit të AK Bashkia Pustec, i përbërë nga:
- N. K.
- S. M.
- N. A.i

Për vitin 2019 është krijuar Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nr.3 prot., datë 24.01.2019, me Urdhër nr.4, datë 24.01.2019 të Titullarit të AK Bashkia Pustec, i përbërë nga:
- N. K.
- S. M.
- N. A.i

Për vitin 2020 është krijuar Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nr.23 prot., datë 03.02.2020, me Urdhër nr.24, datë 03.02.2020 të Titullarit të AK Bashkia Pustec, i përbërë nga:
- V. S.
- L. M.
- J. G.

Nga auditimi i **zonës së llogarisë 602**, për blerjet me vlera të vogla, rezultoi se janë zhvilluar për periudhën objekt auditimi blerje me vlerë të vogël sa vijon:

Vitet	Blerje të vogla		Seleksionuar për t'u audituar bazuar në riskun e auditimit		
	Numër	vlerë	numër	Vlerë	në % ndaj totalit
2018	13	3,264,198	4	1,855,279	56%
2019	11	2,198,023	3	1,074,100	48%
2020	10	3,060,903	4	2,072,700	
Totali	**34**	**8,523,124**	**10**	**5,002,079**	**58%**

Burimi i të dhënave: Drejtoria Ekonomike Bashkia Pustec

Tabela analitike e procedurave të blerjeve me vlerë të vogël të zhvilluar për periudhën 2018 ï 2020 si dhe ato të audituara janë në aneksin bashkëlidhur këtij akt verifikimi
Bazuar tek vlerësimi i riskut janë kampionuar për t`u audituar në total 10 procedura prokurimi me vlerë të vogël, në shumën 5,002,079 lekë ose 58% e vlerës.
Procedurat e prokurimit me blerje me vlera të vogla, të audituara me të dhënat specifike sipas UMF nr.57, datë 12,06.2014, ñPër gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartëò, paraqiten sipas tabelës sa më poshtë vijon:

- Në asnjë rast të përdorimit të formës së prokurimit ñBlerje me vlerë të vogëlò, fondi limit nuk ka qenë mbi 800,000 lekë pa TVSH, pra mbi kufirin monetar të përcaktuar me vendimin e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër rregullat e prokurimit publikò, kreu II, pika 2 si dhe udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 ñPër procedurën e prokurimit me vlera të voglaò të ndryshuar.
- Nga Komisioni i Prokurimit me Vlera të Vogla është zbatuar limiti i përcaktuar për prokurimet me vlera të vogla i cili nuk është tejkaluar në asnjë rast.
- Miratimi i kërkesës për prokurim në të gjitha rastet janë miratuar nga Nëpunësi i Autorizuar i AK.
-Shpallja elektronike në sistem e procedurës, është realizuar në kohën e përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në të gjitha rastet, pasi kanë krijuar në sistem dosjen e tenderit, u janë drejtuar nëpërmjet ftesës për ofertë (sipas formularit nr. 3), 5 (pesë) operatorëve ekonomikë për një periudhë 1-2 ditë nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit.
- Në të gjitha rastet është zbatuar kriteri i çmimit më të ulët për klasifikimin përfundimtar.
- Në të gjitha rastet nga anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, është mbajtur procesverbal për shpalljen e OE fitues, mbi bazën e ofertës më të ulët të shpallur nga sistemi. (Në të gjitha rastet ishin printuar ofertat e gjeneruara nga sistemi).
Në të gjitha rastet OE fitues është njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik. Në rastet e tërheqjes së ofertave të vendeve të para është dokumentuar me shkresat zyrtare nga operatorët ose printimit nga sistemi i emali-ve të kryera nga AK (njoftimi) dhe OE (përgjigja).
- Në dosjen e prokurimeve me vlera të vogla ndodheshin Faturat Tatimore Shitje, të njëjta me vlerën e ofertuar si dhe me urdhër shpenzimet përkatëse.
- Në të gjitha rastet AK ka bërë përllogaritjen e fondit limit, duke u bazuar në ofertat e marra në treg dhe të pasqyruara në dokumentin e hartuar për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.
- Për gjithë periudhën objekt auditimi për procedurat me blerje të vogla, është bërë inventarizimi i dosjeve dhe arkivimi, sipas Udhëzimit nr. 3 datë 03.04.2014,ñPër zhvillimin e Prokurimeve me vlerë te vogël ne sistem të prokurimit elektronik për autoritetin kontraktor dhe operatorët ekonomik ñku thuhet shprehimisht që ñ*Autoriteti kontraktor duhet te bëjë arkivimi e procedurës së prokurimit brenda 1 ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit fitues",* pasi faza arkivimit të kontratës është e papërfunduar.
- Për të gjitha rastet e blerjeve si për shërbimet dhe mallrat është kryer procesi i marrjes në dorëzim të mallit dhe shërbimit nga komisioni i ngritur për çdo rast nga Nëpunësi Autorizues.

Konkluzion: Nga auditimi i pagesave për blerje me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se procedurat në përgjithësi ishin të plotësuara dhe dokumentacioni bashkëlidhur përbën gjurmën e auditimit të këtyre procedurave në të gjitha fazat dhe hapat e kryera për realizimin e këtyre procedurave deri në momentin e kontabilizimit të tyre në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër rregullat e prokurimit publikò i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, kreu II, Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 ñPër procedurën e prokurimit me vlerë të vogëlò, pika 2 dhe me UMF nr.57 datë 12,06.2014 ñPër Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartëò.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare të viteve 2019 dhe 2020 (bilanci), janë mbyllur jashtë afatit ligjorë, konfirmuar me shkresën me shkresë përcjellëse nr. 788 prot., datë 27.07.2020, për vitin ushtrimor 2019 dhe shkresën nr. .777 datë 11.06.2021. për vitin 2020, të konfirmuar nga Dega e Thesarit Korçë, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të viteve 2019-2020 me anekset përkatëse, *pra me 3 muaj vonesë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me shkronjën (d) e pikës 4 e nenit 9, dhe shkronjës (b) e pikës 2 të nenit 12, të ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollit"; UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësinë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 118.*

(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të analizojë shkaqet e mos mbylljes në afat të pasqyrave financiare për vitet 2019 dhe 2020, si dhe të përshkruhet qartë baza mbi të cilën janë përgatitur, duke referuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për klasifikimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Përgjegjësia për raportim në çdo kohë të jetë e dokumentuar jo nëpërmjet shkresës përcjellëse të dërgimit të pasqyrave, por evidentohet në përgjegjësi të plotë në kapakun e pasqyrave financiare, se kush janë hartuesit dhe drejtuesit.

Brenda datës 31.03.2022

2. Gjetje nga auditimi: Në fund tëvitit 2020 llogaria **468 "Debitorë të ndryshëm"** paraqitet në vlerën **129,768** lekë për 33 raste, të cilat përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Konstatohet së vlera **129,768** lekë janë detyrime përpara vitit 2015 të trashëguara nga ish komunat. i ciliështë detyrim i pa definuar, pa dokumentacionin përkatës për t`u paraqitur si detyrim ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera, i mbartur, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur, *në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", kapitulli II, pika 6.*
Sipas akt rakordimit të mbajtura nga sektori i të ardhurave me degën e thesarit, debitorët e subjekteve taksapagues privat dhe familjar, janë në vlerën prej **15,039 mijë** lekë gjendje 31.12.2020. Nga analiza e llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò konstatohet sevlera prej **15,039 mijë** lekë nuk është pasqyruar në kontabilitet. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò*Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme" , aneksi 1, pika 3.3.*

(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në fund të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 15,039 **mijë lekë** sipas evidencave të Sektorin të të Ardhurave Vendore.

2.2. Rekomandimi: Sektori i Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Brenda datës 31.03.2022

3. Gjetje nga auditimi: Llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 6,393,315 lekë, kurse më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 1,437,029 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar pasi llog. 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò përfaqëson vlerën kundër parti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit. Vlera debitorë e kësaj llogarie, nuk është e kuadruar me shumën e llogarive kreditore të pasivit të bilancit, vlera e të cilave është në shumën totale 2,033,221 lekë sipas llogarive dhe as është e analizuar sipas llojeve të detyrimeve të pa paguara si më poshtë vijon:
-Llogaritë 401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò për vlerën kontabël për 435,624 lekë dhe llogaria 467 ñKreditorë të ndryshëmò për vlerën kontabël 1,597,597 lekë. *Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik.*

(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<u>3.1. Rekomandimi:</u> Bashkia Pustec, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merri masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò dhe kundër partisë së saj 467 ñKreditorë të ndryshëmò

<u>3.2. Rekomandimi:</u> Sektori i financës në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 të kryhen veprimet e sistemimit në kontabilitet të llogarisë 401-408 ñ*Furnitorë e llogari të lidhura me to*ò duke pasqyrohen në gjendjen kreditore të llogarisë 467 **"**Kreditorë të ndryshëmò në pasiv të bilancit, detyrimet ndaj të tretëve të lindura nga vendimet gjyqësore si dhe nga detyrimet kontraktore të cilave i ka kaluar afati 60 ditor në vlerën **435,624 lekë.** Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Brenda datës 31.03.2022

4. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 ñStudime dhe kërkimeò, më 31.12.2019 paraqitet në vlerën 2,558,433 lekë, ndërsa më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 18,399,892 lekë, me diferencë në rritje në vlerën 15,841,459 lekë e cila përfaqëson shtimin e tre projekteve për vitin 2020, (Për 2 Blerje projekti studim Uji i Pijshëm dhe Oponence teknike KUZ, Bashkia Pustec).
Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se vlera **2,558,433lekë**, i përkasin 20 projekteve për investimet e kryera, për objekte të cilat kanë përfunduar punimet dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit. Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve *e analizuar sipas aneksit nr.4, pika 3, për projektet, studimet e kërkime dhe vlerat përkatëse, gjendje më 31.12.2020 bashkëlidhur projekt raportit. Veprime dhe mos veprimet janë në kundërshtim të UKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika "c", nën pika "b".*

(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

<u>4.1. Rekomandimi:</u> Sektori i Financës në Bashkinë Pustec të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke krediturar llog. 202 ñ*Studime dhe*

Kërkime" dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Brenda datës 31.03.2022

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën neto) për vitin 2020 është në vlerën **156,289,659** lekë dhe për vitin 2019 është në vlerën**164,540,191** lekë nuk është paraqitur i plotë. Sipas inventarit **kontabël të aktiveve afatgjata materiale** gjendja e llogarive: ***210"Toka, Troje, Terrene"*** është në vlerën 0 lekë; llogaria ***211"Pyje, Plantacione"*** në vlerën 1,793,836 lekë, llogaria ***212 "Ndërtesa Konstruksione"*** në vlerën 44,101,936 lekë; llogaria ***213"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*** në vlerën 96,980,075 lekë; llogaria ***214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** në vlerën 5,764,200 lekë. Sa me sipër pasqyrimi i gjendjes kontabël i aktiveve **nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull**, duke mos përcaktuar vlerën e plotë të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.
Nga Dega e Thesarit Korçë nuk është kërkuar regjistri aktiveve për regjistrimin në sistemin informatikë financiar të qeverisë (SIFQ). Pra nuk ka një data basë me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Bashkinë Pustec, pra duke mos u kryer procesi i informatizimit të tyre, veprime dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò kapitulli III, pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Sektori Ekonomike në Bashkinë Pustec të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një **regjistri analitik aktivesh sipas formatit,** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria 26 ñ*Aktive afatgjata Financiare*ò,sipas pasqyrës financiare paraqitet me vlerë zero lekë për periudhën objekt auditimi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Pustec, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 13/09/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Pustec SHA me NUIS ñL74004003Bò e cila është shoqëri aksionare me objekt ñShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyreò. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqiò. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 58,800 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 58,800,000 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pustec në ñUjësjellës Kanalizime Pustec SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019-2020, më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me

Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materialëò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.

(Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Pustec, nëpërmjet Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek ñUjësjellës Kanalizime Pustec Sh.a me vlerë 58,800,000 lekë, në debi të llog. 26 ñ*Pjesëmarrje në kapitalet e veta"* dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Brenda datës 31.03.2022

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 2,098,102 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh, për objekte të përfunduara dhe në proces. Nga analiza e kësaj llogarie, **konstatohet se:**

a)Në pasqyrat e pozicionit financiar llogaria 466, kreditorë për mjete në ruajtje paraqitet në vlerën 2,098,102 lekë, ndërsa në mënyrë analitike paraqitet në vlerën 2,043,102lekë për 19 subjekte,me diferencë më pak në vlerën 55,000 lekë ei korrespondon taksës së pullës në fund të periudhës 2020

b) Për 19 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, në vlerën 2,043,102 lekë, *sipas aneksit nr.11, pika 3,* nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuara në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. *Veprimet e mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 ñ*Kreditore për mjete nën ruajtje*ò, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pustec nuk ka krijuar sektorin e Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve dhe për rrjedhojë procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Kjo strukturë duhet të realizonte marrjen në dorëzim të aseteve, zbatimin e procedurave tëtransferimit në NJQV, vënien në eficencë të ndërtesave dhe tokës bujqësore produktive dhe jo produktive me sipërfaqe gjithsej 706 ha, duke rritur mundësinë e të ardhurave nga dhënia me qira. Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistër kontabël, në kundërshtim me kapitullin III ñRegjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyreò, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. Bashkia Pustec ka vazhduar punën s*ipas Urdhrit të Kryetarit të bashkisë nr. 166 datë 31.10.2019*

mbi ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e objekteve prioritete të bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksionin territorial të bashkisë Pustecdhe me Udhërin nr. 149 prot, datë 27.09.2021 është bërë zëvendësimi i një anëtari të larguar **.** *Deri në momentin eauditimit* grupi i punës nuk ka përfunduar punës për përcaktimin e *misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e aseteve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.)* dhe për këtë arsye procesi i administrimit të tyre nuk është realizuar. *Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore", transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore", Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore", si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike". (Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandimi: Bashkia Pustec, të marrë masa për krijimin e strukturës së menaxhimit të aseteve, duke përcaktuar në rregulloren e brendshme detyrat konkrete për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Pustec dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore etj, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Pustec, *nuk ka kryer procedurat për inventarizimin* e të gjitha aktiveve afat gjata jo materiale dhe materiale të investuara në vite nga Bashka Pustec dhe ato që me miratim të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të kësaj bashkie, konkretisht për llogaritë (me kostot historike):

Llogaria 202 ñStudime dhe kërkimeò për vlerën 18,399,892 lekë
Llogaria 211 ñ*Pyje kullota plantacione"* për 1,793,836 lekë.
Llogaria 212 ñ*Ndërtime konstruksione*ò për 50,082,499 lekë.
Llogaria 213 ñ*Rrugë rrjete vepra ujore*ò për 123,401,363 lekë.
Llogaria 214 ñInstalime teknike, makineri, pajisje, vegla puneò për vlerën 8,527,462 lekë
Llogaria 215 *"Mjete transporti*ò për 36,425,797 lekë.
Llogaria 218 ñInventar ekonomikò për vlerën 5,241,702 lekë

-Nuk është përgatitur regjistri i pronave.
-Nuk është bërë regjistrimi i aktiveve në pronësi të Bashkisë.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë; Kap. VII, neni 23, pika 14 –Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj , UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme". Kap III. Më hollësisht trajtuar në pika 2, faqet 37-58. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në

pronësi të vet të kaluara me VKM-të përkatëse, si dhe për krijimin e regjistrit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, i ndryshuar.

Brenda datës 31.03.2022

